

"DREJT PUNES" ► FAQE 13-16



Si të ruajmë identitetin e kulinarisë shqiptare
Flet chef Flori Neziri

"ÇESHTJA FRROKU" ► FAQE 4-5

Vonesa me 2 ditë që solli largimin e Didit e arrestin e Bajraktarit

Zbulohet dinamika e plotë e urdhër-ndalimit të Mark Frrokut që mbërriti më 18 mars nga Belgjia



KOMENT



NGA **FATMIR MERKOÇI**

Ligje farsë apo të vërteta?

DEKRIMINALIZIMI
Nëse është i vërtetë, është mjaft i thjeshtë për t'u zbatuar. Mirëpo shtetarët tanë po mbushin emisione të tëra duke kërkuar kush e kush të fitojë pikë në popull.

► vijon në faqen 19

"PERIFERI"



NGA **ALBA MALLTEZI**

Vetmia e njerëzve të mirë

Nuk është nevoja të bëhen sondazhe për të kuptuar se sa e duam të drejtën, të vërtetën në shqiptarët. Ku jetojmë e punojmë, lehtësisht vërehen flirtimet me korruptionin në nivele të ndryshme, sipas mundësive dhe kontakteve me pushtetin.

► vijon në faqen 19

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30

VITI V - NR. 75 - E ENJTE - 02-04-2015

SHPERTHEJNE Puset NE MARINZE

BANKERS PUNONTE ME LICENSE TE PEZULLUAR



Ministria e Mjedisit ia kishte ndaluar punimet kompanisë kanadeze që 27 shkurt 2015. Zbardhet raporti: Ndotje e madhe, rrezikohet jeta e banorëve

Shpërthimi i ujërave nëntokësore në oborret e banesave dhe çlirimi i gazrave, detyroi autoritetet të evakujnë banorët nga rreziku i ndotjes së mjedisit

► FAQE 2-3

LISTA E PLOTE ► FAQE 10-11

Legalizohet trualli i 700 objekteve të ndërtruara pa leje

Qeveria miraton kalimin e parcelave ndërtimore për pronarët

VENDIMI I QEVERISE ► FAQE 12




Ja cilat objekte do përjashtohen nga legalizimi, kriteret

Këshilli i Ministrave përcakton kushtet e reja për kualifikimin e objekteve informale



Rama tregon në Shkodër historinë e prishjes me Doshin

► FAQE 9



NGA **MILTIAKH M. MUÇI**

24 VITE NGA VRASJA E 4 PROTESTUESVE ► FAQE 20-21

E vërteta e 2 prillit në Shkodër, skenari i vrasjeve me snajper

Dëshmitë e Harris Muranës e Gjek Çelajit

BMC Blue Medical Center
Vizita, Analiza & Diagnostikim
Të garantuara sipas protokolleve të mjekësisë bashkëkohore nga Blue Medical Center

Të parandalosh, më mirë se të kurosh!

Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë
Tel: + 355 4 2370 868
Cel: +355 66 20 90 008
Email: info@bmc.al, www.bmc.al

» KATASTROFA

MBYLLEN shkollat dhe evakuohen banorët në zonën naftëmbajtëse. Kompania: është gaz i ëmbël

Shpërthejnë pusët e “Bankers”, orë tmerri në Marinzë

Eksplodimet njëri pas tjetrit, banorët “rrembejnë” fëmijët dhe orenditë e lanë shtëpitë

LORENC RABETA
TIRANE

Banorët e fshatit Marinzë e kanë kaluar gjithë ditën e djeshme nën tmerrin e shpërthimeve të shkaktuara nga dy puse naftë, të cilat krijuan gjithashtu edhe dhjetëra vatra që lëshonin gaz. Shpërthimi i ujërave nëntokësore në oborret e banesave dhe çlirimi i gazrave në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinzë detyroi autoritetet të evakujnë banorët nga rreziku i ndotjes së mjedisit. Shpërthimet e fuqishme nisën prej orës 05:00 të mëngjesit të deshmë në fshatin Marinzë. Disa puse naftë shpërthyen njëri pas tjetrit duke detyruar banorët të “rrembejnë” fëmijët dhe orenditë e të largohen nga shtëpitë. Mësimi është ndërprerë në disa shkolla dhe rreth 60 familje u evakuuan. Dëmet e shkaktuara nga shpërthimet qenë të shumta, ndërsa shfaqja e vazhdueshme e vatrave të vogla u kthye në makth për banorët e zonës. Shumë prej tyre shpërthyen nëpër themelet dhe oborret e shtëpive. Kryeplaku



Mbrëmja

Vetëm në mbrëmje shpërthimet ndaluan dhe intensiteti i vatrave të gazit nisi të binte. U kthye edhe energjia elektrike, por oborret e shtëpive qenë të mbuluara nga llumi

Luan Zyko tregoi se firma u vuri në dispozicion një banesë magazinë në Belinë, në kufi me Marinzën, për të strehuar banorët e evakuuar, por askush prej tyre s’e pranoi evakuimin për shkak të gjësë së gjallë e shtëpive. Mësimi është ndërprerë. Ashtu si dhe uji, i mbushur tani me shtrese naftë u pusët e oborreve.

VATRAT E LLUMI

Situata u qetësua disi vetëm gjatë orëve të mbrëmjes, kur shpërthimet u ndërpre në intensiteti i rrjed-

hjes së gazit nga vatrave të vogla nisi të ulej. Në orët e vona, banorët e Marinzës qëndronin në vijën ndarëse me zonën e shpërthimeve pa pranuar evakuimin, duke mos pranuar të linin

shtëpitë në mëshirë të fatit. Në mbrëmje u kthye edhe energjia elektrike, por oborret e shumë shtëpive ende qenë të mbuluara nga llumi. Në një nga 60 shtëpitë e dëmtuara nga shpërthimi i mëngjesit, te banori Pandeli Konomi oborri është ende nën llum. Pusi i ujit ka shpërthyer nga 80 metër nëntokësorë në hardhitë e kopshtit. “Të mos na iki toka, se boshllëku i gazit me ç’do mbushet nën këmbët tona...shtëpia shihet është çarë në copa dhe tavan, edhe oborri ja kjo vijë

e re ndarëse...”, thotë banori, rreth të 60-ave. Banorët u shprehën të pakënaqur nga instancat shtetërore sa i përket ndihmës për strehim dhe asaj ushqimore.

SHTETI

Ministri i Energjetikës Damian Gjinkuari mbërriti në fshat për të monitoruar nga afër situatën, ku mbajti një qëndrim të ashpër ndaj kompanisë “Bankers”, e cila, sipas tij, duhet të japë llogari që ka vënë në rrezik banorët. Specialistët e

SHPËRTHIMI

Ujërat 200 metra larg pusit



— Çlirimi i gazrave si pasojë e shpërthimit në pusin e naftës numër 8, ka detyruar autoritetet të evakujnë banorët nga shtëpitë e tyre. Në orët e mesditës është regjistruar edhe një shpërthim i tretë, ndërkohë që kanë qenë të shumta vatrave të vogla pranë shtëpive, që shfrynin gaz. Ujërat nëntokësorë u shpërndanë rreth 200 metra larg pusit, duke hyrë në banesa dhe tokat bujqësore, ndërsa u ndërpre mësimi në shkollën e fshatit, që ndodhet shumë pranë zonës së shpërthimit. Nga shpërthimi i fuqishëm u bllokua edhe rruga që lidh Marinzën me Fierin. Në vendngjarje kanë mbërritur menjëherë forcat policore dhe ato zjarrfikëse, si dhe ekspertë të kompanisë shtetërore të naftës “Albpetrol” dhe të “Bankers”-it. Rreth 80 familje u larguan nga banesat dhe u strehuar tek të afërmit, por shumë të tjera nuk kanë pranuar të lënë shtëpitë e tyre, pavarësisht rrezikut që mund t’u kanoset.

Shpërthimet

Shpërthimet nisën prej orës 05:00 të mëngjesit. Disa puse naftë shpërthyen njëri pas tjetrit duke detyruar banorët të “rrembejnë” fëmijët dhe orenditë e të largohen nga shtëpitë

“Bankers Petroleum” thanë se aksidenti ka ndodhur për shkak të një rrjedhjeje natyrore e gazit gjatë punës për shpimin e pusit. Rreth mesditës, ministri Damian Gjinkuri mbledhi në një takim urgjent administratorin e “Albpetrol”-t Endri Puka, Prefektin e Fierit, përfaqësues të “Bankers Petroleum” dhe deputetë të zonës në lidhje me shpërthimet në pusët e naftës nga “Bankers”. Prefekti i Fier Xhevit Bushi në një lidhje telefonike për A1 Report tha se situata po vjen drejt normalizimit, ku po merren masa nga ana e kompanisë “Bankers Petroleum” për të vënë nën kontroll shpërthimin.

Reagimi

TIRANE

Nga ana e saj, kompania “Bankers Petroleum Albania” e cilësoi aksidentin si të parrezikshëm, pasi bëhej fjalë për “gaz të ëmbël”, pra të padëmshëm për jetën e banorëve. Në një deklaratë për shtyp, kompania theksoi se dhe në mëngjes në ora 6.00, kompania “Bankers Petroleum Albania Ltd” aktivizoi planin e ndërhyrjes për emergjencat,



Gropa e shkaktuar nga gazi

“Bankers”: Gazi që rrodhi është i ëmbël, i padëmshëm

Reagon kompania: Vazhdojnë operacionet për mbylljen e pusit

në përgjigje të një rrjedhjeje të pakontrolluar gazi natyror në një pus, kur po kryeshin operacione shpimi. Nuk raportohen të lënduar. “Gazi që ka rrjedhur është gaz i ëmbël dhe i padëmshëm, megjithatë stafi operacional dhe i sigurisë i “Bankers” në bashkëpunim me qeverinë lokale, ‘Albpetrol’ dhe Po-

licinë e Shtetit ka marrë të gjitha masat paraprake, duke përfshirë edhe evakuimin e menjëhershëm të banorëve në zonën e prekur”, theksonte kompania në deklaratë. Sipas saj, operacionet po vazhdojnë për ta ndaluar pusin, për të kthyer banorët në shtëpitë e tyre dhe, më pas, për të filluar operacionet për pastrimin e

zonës e prekur. Shfrytëzimi i burimeve nëntokësore të naftës në fushën e Patos-Marinzës është bërë jo pak herë objekt i lajmeve në media. Vitet e fundit banorët e zonës kanë dalë disa herë në protestë për shkak të lëkundjeve të forta, që kanë dëmtuar tej mase edhe banesat e tyre. Vetë

kompania ka mohuar se ato vijnë për shkak të operacioneve hidrokarbure që kryen ajo. Për zgjidhjen e situatës, Ministria e Energjisë në bashkëpunim me kompaninë kanë vendosur sizmiometra për të suduar lëkundjet e për të përcaktuar nëse ato vijnë si pasojë e tërmeteve apo si pasojë e shpimeve.



Dy pusët e naftës në momentin e shpërthimit

Inspektimi




DRIÇIM ÇAKA
TIRANE

Bankers Petroluëm vazhdoi të kryente punime në Marinzë dhe Zharrës të Fierit pavarësisht se Ministria e Mjedisit kishte dhënë urdhër për pezullim më 27 shkurt 2015 deri në plotësimin e kushteve. Në datën 24 shkurt një grup pune i Ministrisë së Mjedisit filloi inspektimin në aktivitetin e kompanisë “Bankers Petroluëm Albania Ltd”, ku një nga çështjet kryesore ishte situata në gropat ekologjike, të cilat përmbajnë mbetje të rrezikshme. “Nga inspektimet rezultoi se Gropat Ekologjike 1 dhe 2 në fshatin Zharrës janë shumë pranë njëra-tjetrës, nuk janë të rrethuara, s’ka roje dhe tabela paralajmëruese. Pranë perimetrit të gropës lëvizin persona të paautorizuar, ka rrezik të përhapjes së ndotjes jashtë perimetrit të gropës. Për problematikën e shkarkimit të ujrave përcaktohet se ujrati e shiut që grumbullohen në gropat ekologjike duhet të largohen me anë të një tubacioni ose mjete të tjera në pusët e injektimit të ujit. Në asnjë pikë të lejeve dhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nuk parashikohet shkarkimi i ujrave të patrajtuara në mjedis. Ujërat e ndotura që nuk arrijnë karakteristikat e përcaktuara në akte nënligjore, ndalohen të shkarkohen direkt në tokë, në ujë dhe në sistemin publik të kanalizimeve”, - thuhet në raportin përfundimtar të inspektimit, të përfunduar në 27 shkurt 2015.

“Bankers” punoi edhe pse ishte pezulluar që më 27 shkurt

Raporti: Ndoti bregdetin e Fierit e lumenjtë Seman e Gjanicë. Rrezikohet jeta e banorëve

Ndotje e zonës bregdetare si rezultat i shkarkimit të ujrave të ndotura. Prombleme sociale dhe shëndetsore mbi banorët e zonës dhe cenim i rënduar i mjedisit natyror. Rreziku nga thatësira për shkak të avullimit të fraksioneve të lehta të hidrokarbureve. Rreziku i aksidenteve nga zjarret. Ndotje e ujrave të lumit Seman e Gjanicë përbën rrezik direkt për prodhimet bujqësore, si pasojë e përdorimit të ujit për ujtitjen e tokave. Mospërputhje me realitetin në terren si dhe përshtirja jo i saktë i Studios Mjedisore, të projektit dhe komponentëve përbërës të Gropave Ekologjike”, - janë disa nga arsyet që u pezullua “Bankers Petroluëm”, përcaktonte raportin përfundimtar i inspektimit të Ministrisë së Mjedisit.



● Raporti përfundimtar i grupit të punës të Ministrisë së Mjedisit që ka inspektuar “Bankers Petroluëm” dhe ka vendosur heqjen e lejes mjedisore pa afat

DY AKUZAT
Policia dhe Prokuroria nisin hetimet ndaj Bankers



— Prokuria e Fierit dhe Policia ditën e djeshme kanë nisur hetimet ndaj kompanisë “Bankers Petroluëm”. Akuzat ndaj kësaj kompanie është zhvillim i punimeve pa leje, duke qënë se Ministria e Mjedisit i kishte pezulluar lejen në 27 shkurt 2015. Gjithashtu Policia dhe Prokuroria e Fierit do të nisin hetimet edhe për thellësinë e puses dhe dsitancën e afërt që kanë me banesat. Banorët shpesh kanë denoncuar kompaninë “Bankers Petroluëm”, për shpimet e puses gjatë natës dhe dëmtimet që kanë pësuar shtëpitë e tyre, ndërsa Bankers është justifikuar se kanë qënë tërmete të nëndheshme dhe jo shpërthime nga kompania.

ISHMP
Agasi: Shpërthimet në Fieri ende të paqarta



— Inspektorjati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyeve në një reagim ditën e djeshme tha se shkaqet teknike të këtij incidenti janë akoma të paqarta dhe do të zbardhen shumë shpejt. “Arsyet e shpërthimit mund të jenë të lidhura me konstatimet e bëra nga ISHMP gjatë javëve të kaluara, masat administrative të marra ndaj kompanisë Bankers dhe rekomandimet e pazbatuara nga kjo kompani, të bera nga ana e jonë”, - tha në dalje për shtyp drejtori i Inspektorjatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyeve Ergis Agasi. Gjithashtu ISHMP ka dërguar inspektorët e saj në Fier për të zbardhur arsyet e shpërthimeve.

NËNTË PROBLEMATIKAT

Sipas grupit të punës që kreu inspektimin e Bankers Petroluëm problemi që u pezulluan punimet ishte mungesa e një plani të detajuar për menaxhimin e mbetjeve që gjenerohen nga aktiviteti i kompanisë, pasi të gjitha gropat ekologjike nuk kanë kapacitet depozitues e për pasojë kanë mbaruar funksionin. “Ndotje e burimeve ujore dhe basenit ujëmbledhës Seman. Rreziku i një përmblytje të mundshme të zonës dhe përhapja e ndotjes për shkak të mosfunksionimit të largimit të mbetjeve hidrokarbure. Rreziku i një përmblytje të mundshme dhe përhapja e ndotjes për shkak të mosfunksionimit të mbetjeve hidrokarbureve.



Raporti

Bankers nuk duhet të punonte pa hartuar një plan të ri

— Në fund të raportit për inspektimin e “Bankers Petroluëm”, nga grupi i punës u lanë disa detyra dhe pa plotësuar gjashtë kushtet e mëposhtme Bankers nuk duhet të vazhdonte aktivitetin. Me Urdhër të Ministrisë së Mjedisit, Lefter Koka i është kërkuar kompanisë “Bankers Petroleum Albania”, me qëllim parandalimin e aksidenteve të mundshme dhe ndotjes potenciale të mjedisit, që kjo kompani të zbatojë këto masa dhe detyra:
Pezullimi i aktiviteteve të kompanisë deri në paraqitjen e planit të menaxhimit të mbetjeve.
Hartimi i Planit të Përputhshmërisë sipas përcaktimeve të shtojcës 10 të ligjit nr. 10448 datë 14.07.2011 për lejet në mjedis, e ndryshuar.

Rivlerësimin e raporteve të ndikimit në mjedis dhe rishtikimin e kushteve të lejeve Mjedisore.
Hartimi i një plani monitorimi të detajuar si pjesë e Lejes Mjedisore dhe instrumentave të inspektimit mjedisor.
Kompania në përputhje me planin e menaxhimit duhet të fillojë hartimin e planit të masave për trajtimin e mbetjeve që gjenerohen nga aktiviteti, të depozituara në gropat ekologjike.
Menaxhimi i mbetjeve të të gjitha llojeve duhet të bëhet në përputhje me kuadrin e ri ligjor të mbetjeve. “Heqja e masës së pezullimit të aktivitetit të kompanisë do të bëhet pas vlerësimit të realizimit të masave dhe detyrave të lëna për zbatim”, - përcaktonte raportin.

» “FRROKU”

PARLAMENTI ka përcaktuar që si çështje të parë në diskutim për rendin e ditës së sotme të jetë kërkesë e Prokurorit për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë së deputetit Mark Frroku




Këshilli
Pavarësisht mohimit të akuzave nga Frroku, Këshilli i Mandateve votoi ditën e martë për të sjellë në seancë plenare kërkesën e prokurorisë për arrestimin e tij



Avokatët
Avokatët e deputetit Frroku, Sajmir Visha dhe Genc Gjokutaj kanë paraqitur një kërkesë në Prokurori për pjesëmarrjen e klientit të tyre sot në seancë plenare



Votimi
Nëse Kuvendi do të votojë për autorizimin e Prokurorisë, Frroku do të duhet të rikthehet sërish në qeli pasi do të përballet edhe me akuzën për vrasje



PROCEDURAT

Kuvendi voton sot për arrestimin e dytë të Frrokut

Prokuroria jep autorizimin që deputeti të mbrojë veten në seancë

Faksimile e Prokurorisë që autorizon Mark Frrokun të marrë pjesë sot në seancë

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANE

Kuvendi pritet të përsërisë sot vetveten me vendimin për miratimin e kërkesës së Prokurorisë së Përgjithshme për arrestimin e deputetit Mark Frroku. Një javë pasi miratoi një tjetër kërkesë të Prokurorisë për arrestimin e kreut të Partisë Kristian Demokratike, Frroku në funksion të çështjes “Doshi”, seancës i është përcjellë një tjetër raport nga Këshilli i Mandateve për dhënien e autorizimit për arrestimin e deputetit. Njësoj si në seancën e një javë më parë, Kuvendi ka përcaktuar që si çështje të parë në diskutim për rendin e ditës së sotme të jetë kërkesë e Prokurorit të Përgjithshëm për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë së deputetit të Kuvendit të Shqipërisë Mark Frroku. Pas paraqitjes së dy raporteve që kanë ardhur në seancë nga Këshilli i Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit, është parashikuar që edhe vetë deputeti Mark Frroku të bëjë mbrojtjen e tij përpara kolegëve, për të kërkuar rrëzimin e kërkesës së dërguar nga Prokuroria për arrestimin e tij.

dhe Genc Gjokutaj kanë paraqitur në prokurori një kërkesë për pjesëmarrjen e klientit të tyre sot në seancë plenare. Pas autorizimit të dhënë nga organi i akuzës, Frroku do të jetë sot në seancë plenare për të bërë mbrojtjen e tij përpara kolegëve që një javë më parë votuan

për arrestimin e tij. Njësoj si në seancën e zhvilluar në Këshillin e Mandateve, Frroku do të vijë i shoqëruar nga forcat e policisë të cilat do ta shoqërojnë atë deri në brendësi të ambjentëve të Kuvendit. Deputeti Frroku pritet të mbajë të njëjtin qëndrim në seancë në lidhje me ngjar-

jen për të cilën akuzohet, duke mohuar autorësinë e veprës penale. Nëse Kuvendi do të votojë për autorizimin e Prokurorisë, Frroku do të duhet të rikthehet sërish në qeli pasi do të përballet edhe me akuzën për vrasje të ardhur nëpërmjet interpolit nga shteti belg.



Lulzim Basha

“Tahiri mallkim për vendin, Rama futi Frrokun në Parlament”

Kryetari i Partisë Demokratike, Basha ka kërkuar dje dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Gjatë mbledhjes së grupit parlamentar të PD-së u analizua situata e rëndë e krijuar në vend, ndërsa u theksua se fshehja e kërkesës së Interpolit për deputetin Mark Frroku, i akuzuar nga prokuroria belge për vrasje, është një fshehje krimi dhe në dy data të ndryshme, duke injoruar kërkesën e një vendi mik të Bashkimit Evropian. “Shqiptarët e dinë se Edi Rama futi në parlament Frrokun dhe fshehu provat, fshehu të vërtetën e rasisë të deputetit Frroku. Tani që skandali ka shpërthyer dhe tronditi opinionin vendas e ndërkombëtarë, kërkohet që kryeministri të marrë përgjegjësi. Dorëheqja e Drejtorit të Policisë është një marrëveshje dhe vazhdim i një pakti kriminal”, tha Basha.



Opozita s’do të braktis votimin për Frrokun, voton pro arrestimit

Proetsta, PD kërkon dorëheqjen e Metës sot nga qyteti i Shkodrës

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka mbledhur dje grupin parlamentar demokrat ku ka dhënë direktivat që duhet të njekin deputetët në seancën plenare të ditës së sotme. Në mbledhjen e dyer të mbyllura, deputetëve demokrat iu është diktuar qëndrimi që do të mbajnë në seancën plenare për projektligjet që do të votohen dhe kryesisht me pikën e parë të rendit të ditës, e cila është kërkesa e Prokurorisë për arrestimin e Mark Frrokut. Bruime nga selia blu bëjnë me dije se në mbledhjen e grupit është marrë



vendimi për të votuar pro kërkesës së Prokurorisë së Përgjithshme për të arrestuar Frrokun për llogari të drejtësisë belge që e akuzon deputetin për vrasjen e një shqiptari në vitin 1999. Ndërkohë që përveç kësaj, direktivat e tjera lidhen me diskutimet intensive që do të mbajë opozita gjatë ditës së sotme në seancë plenare ku përveç diskutimit për projektligjet do të denoncojë nga foltorja e Kuvendit disa prej problematikave të qytetarëve. Ndërkaj,

opozita gjatë ditës së sotme sipas direktivave të dhëna në mbledhje grupi, do të votojë pro projektligjit për përfaqësimin me 50 % të grave në këshillat bashkiak. Gjithashtu, grupi parlamentar i Partisë Demokratike vendosi se protesta e radhës e opozitës do të mbahet në orën 11:00 në qytetin e Shkodrës. E cila është vazhdimësi e përhallëzimit të protestave për dorëheqjen e kreut të Kuvendit Ilir Meta. Megjithatë në seancën e shkuar par-

lamentare, opozita braktisi votimin për kërkesën e Prokurorisë që kërkoi autorizimin e Kuvendit për arrestimin e deputetëve Tom Doshi dhe Mark Frroku në lidhje me historinë e atentatit që Doshi pretendon se ishte planifikuar gjashtë muaj më parë për vrasjen e tij dhe të demokratit Mhill Fufi, me udhër të kryeparlamentarit Meta. Mesila Doda ishte e vetmja që qëndroi në sallë dhe që dha votën e saj pro arrestimin e deputetëve.



Mark Frroku duke dalë nga Drejtoria e Policisë

Vonesa me 2 ditë që solli largimin e Didit dhe arrestin e Bajraktarit

Zbulohet dinamika e plotë e urdhër-ndalimit për deputetin Frroku, të akuzuar për vrasje

Një vonesë prej vetëm dy ditësh ka sjellë arrestimin e kreut të zyrës së Interpol Tiranë Artan Bajraktari dhe specialistes Loretta Alla, ndërkohë ka detyruar dhe kryepolicin Artan Didi të japë dorëheqjen. Gazeta "Shqiptarja.com" ka arritur të mësojë të gjithë dinamiken që ka ndjekur urdhër-arresti i lëshuar nga autoritet e drejtësisë belge për deputetin Mark Frroku dhe bashkëpuntorët e tij si dhe veprimet që ka kryer shefi i Interpol Tiranës për ta përcjellë urdhërin tek eprorët e tij. Sipas verifikimeve treguar dhe në sallën e gjykatës nga avokati i Bajraktarit Ardian Visha, ka qenë një gabim dy ditë, pasi njoftimi për shpalljen në kërkim të Mark Frrokut, ka mbërritur në Tiranë të enjten në 18 mars të 2015, nga zyra e Interpolit në Lion. Sipas legjislacionit, shefi i zyrës së Interpolit apo specialistët kanë detyrën që pasi administrojnë shkresën që vjen nga jashtë, që në këtë rast kishte mbërritur nga Belgjika, brenda 5 ditësh e siglojnë këtë material dhe njoftojnë eprorët e tyre. Mirëpo Bajraktari ka qenë disa ditë me leje, për shkak se e shtuna dhe e diela ka rezultuar pushim, ky informacion ka qëndruar dy ditë në sirtar, për t'u dërguar me pas në Prokurori të Përgjithshme dhe në Ministrinë e Drejtësisë vetëm të premtën në 27 mars 2015. Nga afati ligjor prej 5 ditësh që duhet të shkonte në prokurori, informacioni për Mark Frrokun ka mbërritur brenda 7 ditëve pune, duke kaluar afati për një periudhë dy ditore. Por ishte pikërisht kjo "gafë" që solli arrestimi e kreut të Interpol Tiranë z.Bajraktari, specialistes Loretta Alla. Arrestime këto që më pas u shoqëruan dhe me dorëheqjen e kreut të Policisë së Shtetit Artan Didi.



Artan Bajraktari

Didi në pyetje

Mësohet se lidhur me këtë çështje pritet të pyetet në prokurori dhe kryepolicin Artan Didi, i cili mësohet të ketë pasur dijeni për urdhërin e arrestit për Frrokun

Lirimi në gjyq

Arrestimi i Bajraktarit është cilësuar si i paligjshëm nga gjykata dhe nuk është vendosur masa e pezullimit nga detyra. Ndërsa për shtetasen Loretta Alla ndalimi ishte i ligjshëm dhe është pezulluar nga detyra.

KRONOLOGJIA

8 janar 2015

Në janar të këtij viti prokuroria belge ka urdhëruar që emri i Mark Frrokut të rregjistrohet si person në kërkim në zyrën e EUROPOL. Agjentët e kësaj zyre kanë kryer verifikim në BE, po informacionet treguar se Frroku ndodhej në Shqipëri.

18 mars

Në pamundësi për të arrestuar Frrokun në Shqipëri, EUROPOL ia dërgon urdhërin e arrestit Interpolit në Tiranë në datën 18 mars të 2015. Njoftimi është marrë pikërisht në këtë datë nga z.Bajraktari, ndërkohë që është njoftuar dhe prokuroria.

26 mars

Një ditë pasi Mark Frroku të arresohet së bashku me deputetin Tom Doshi për akuzën e "Kallëzimit të rreme" dhe "Deklarimit të rremë para prokurori" Interpol Tirana përcjell dokumentacionin në Prokurorinë e Përgjithshme për arrestimin e Frrokut.

27 mars

Në këtë datë zyra e Interpol Tiranës ka njoftuar zyrën e Marrëdhënive me Jashtë pranë Prokurorisë së Përgjithshme si dhe ministrisë e Drejtësisë, për mbërritjen e këtij njoftimi për arrestimin e shtetasit të akuzuar për vrasje Mark Frroku.

28 mars

Ministria e Drejtësisë i drejtohet me një shkresë sërisht Zyrës së Marrëdhënive me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme duke e informuar se autoritet belge kërkoni arrestimin e deputetit të PKD Mark Frroku, pasi kishin të dhëna se ndodhej Shqipëri.

28 mars

Sapo ka marrë dy shkresat nga ministria dhe zyra e Interpolit, Prokuroria e Përgjithshme ka rregjistruar procedimin nr.2 ndaj Mark Frrokut, këtë herë për akuzën e "Vrasjes me paramendim". Pikërisht në këtë datë është kërkuar imuniteti i tij.

29 mars

Kërkesa për heqjen e imunitetit të Mark Frrokut ka mbërritur në Kuvend, ndërkohë që ditën e diel ku vendi kishte caktuar mbledhjen për diskutimin lidhur me heqjen e imunitetit për arrestimin e Mark Frrokut.

31 mars

Pikërisht në këtë datë Këshilli i Mandanteve është mbledhur ku ka diskutuar lidhur me heqjen ose jo të imunitetit të Mark Frrokut. Në fund me vota unanime është vendosur pranimi i kërkesës së prokurorisë për vijimin e hetimeve ndaj Frrokut.


2 prill

Sot ka shumë gjasa që të kryhet arrestimi i dytë i deputetit Mark Frroku. Ky i fundit do jetë nesër në Kuvend, ndërkohë që kolegët e tij do votojnë pro heqjes së imunitetit të tij dhe dërgimin e Frrokut në dyert e prokurorisë dhe gjykatave.

NË 3 PRILL VENDIMI

Arben Frroku kërkon drejtësi dhe pafajësi

— "Drejtësi dhe pafajësi", ka qenë kjo kërkesa e Arben Frrokut nën akuzë për vrasjen e kryepolicit Dritan Lamaj drejtuar Gjykatës së Krimeve të Rënda në përfundim të procesit gjyqësor ndaj tij. Pas kafazit të hekurit, i pandehuri Arben Frroku ka kërkuar drejtësi dhe pafajësi duke thënë se nuk ka pasur arsye për të vrarë shefin e komisariatit numër 6 Dritan Lamaj. Frroku ka bërë replika me prokurorin Anton Martini, i cili në seancën e fundit në procesin Frroku i ka qëndruar kërkesës për burgim të përjetshëm. I pandehuri i ka pohuar prokurorit se e kishte kthyer personale me të, ndërkohë që nga ana tjetër prokurori i është përgjigjur se janë provat ato që e kryqëzojnë Frrokun për vrasjen e ish-kryekomisarit Dritan Lamaj. Ndërkohë avokatët mbrojtës gati 4 orë paraqitën konkluzionet e mbrojtjes së klientit të tyre përballë akuzave se ka vrarë kryekomisarin e kombinatit Dritan Lamaj në shkurt të 2013-ës. Ata kërkuar të mos merren si provë deklaratimet e dëshmitarit Arben Ndoka e bashkëshortes së tij. Sipas mbrojtjes këto dëshmi janë sajësë e paguar dhe në këtë kushte nuk përbëjnë provë. Pritet që në datën 3 prill gjykata të vendosë dënimin ose jo të Arben Frrokut.



Arben Frroku

FRROKU DHE EUROPOL

Por surpriza nuk mbarron këtu. Mësohet se deputeti i PKD Mark Frroku nuk ka qenë në kërkim ndërkombëtar nga Interpoli, por në 8 janar emri i tij është publikuar vetëm në listën e të kërkuarve të EUROPOL-it. Pikërisht ligjet europiane lejojnë që EUROPOL të veprojë brenda një territori juridiksional që janë shtetet të cilat aderojnë në Bashkimin Europian. Ndërsa jashtë këtyre shteteve, Frroku nuk mund të arresohet: në rastin konkret ai ndodhej në Shqipëri e cila nuk është në EUROPOL. Në fakt EUROPOL kishte mundësi për të kërkuar nga Interpoli një urdhër-arresti ndërkombëtar, gjë që nuk ka ndodhur se Mark Frroku në çdo rast nuk mund të arresohet pasi nuk ekziston një marrëveshje ekstradit midis Shqipërisë e Belgjikës, që është vendi që ka kërkuar arrestimin. Në këtë rast EUROPOL ka lajmëruar Shqipërinë që Frroku është në kërkim. Pikërisht në datën 18 mars në zyrën e Interpol Tiranës ka mbërritur një njoftim i tillë, i cili pas pak ditësh e ka Bajraktari i cili e ka siglur "...të veprohet menjëherë..." dhe ka kaluar

tek specialistja Loretta Alla, e cila më datë 27 mars i ka kaluar Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë. Prokuroria e Përgjithshme pas lajmërimit ka të drejtë siç po ndodh të urdhërojë arrestin e Mark Frrokut dhe të kërkojë nga drejtësia belge kopjen e dosjes penale, porn e çdo rast gjyqi për vrasje duhet të zhvillohet në Shqipëri se Frroku nuk mund të ekstradohet.

NGATËRRESA ME BYTYÇIN

Po pse është përfolur për një lajmërim nga Interpoli që në janar 2015? Sipas avokatit Visha duket se urdhëri i arrestit i ardhur në 8 janar të këtij viti nga Belgjika në fakt ishte për Kristian Marinaj, alias Arjan Bytyçi, një tjetër shqiptar i akuzuar si bashkëpuntor me

Mark Frrokun në vrasjen e shtetasit Aleksandër Kurtit, dhe kjo mesa duket ka ngatërruar organet ligjzbatuese të vendit. Kristian Marinaj u prezantua si qytetar serb dhe për këtë arsye personeli i Interpolit në Tiranë nuk e ka analizuar si dokument. Sipas policisë që ka arrestuar Bajraktarin nëse ai kishte analizuar urdhër-arrestin për Marinaj brenda kishter gjetur edhe emrin e Mark Frrokut, ndërkohë avokati mbrojtës, drejtori i Interpol Tiranë, nuk kishte asnjë detyrim në këtë drejtim. Gjykata ka vendosur që kishte të drejtë të kështu ka liruar dy oficerët. Nëse në të vërtetë kjo ka qenë gjithë historia, atëherë skandali i Interpolit nga arrestimi i Bajraktarit deri tek dorëheqja e Artan Didi ka qenë një vepër tepër i nxjerrur.

■ **NGJARJA NË 2003**

Shtetasi L.J 53 vjeç, banues në Lepenicë, në vitin 2003 ka vrarë me armë zjarri shtetasin Bujar Alliaj (vëllai i porositësit) dhe u dënua me 10 vite burg

■ **HETIMET E POLICISË**

Luka Sherifaj prej disa kohësh vëzhgonte personin që do të vriste dhe se pas kryerjes së krimit ai do të largohej nëpërmjet zonave malore në afërsi të fshatit

15 milion lekë vrasësit me pagesë për hakun e të vëllait

Policia parandalon krimin. Pranga porositësit, vrasësi me pagesë si edhe një bashkëpunëtor i tij

XHENSILA KODRA
VLORE


Një vrasës me pagesë është arrestuar nga Policia e Vlorës, duke zbuluar kështu zinxhirin kriminal që nga porositësi i vrasjes e deri tek ekzekutori dhe një bashkëpunëtor i tij. Një 56 vjeçar, për të marrë hakun e vëllait të tij të vrarë që në vitin 2003, i ka paguar një shumë prej 15 milion lekësh një vrasësi me pagesë. Në këtë mënyrë, në prangat e policisë kanë rënë porositësi i vrasjes Mersin Alliaj, vrasësi me pagesë Luka Sherifaj, si dhe bashkëpunëtori i tij Ledjon Muho.

NGJARJA

Policia e Vlorës ka parandaluar një vrasje duke vënë në pranga tre autorët e krimit. Ngjarja ndodhi në orët e mëbrëmjes të së martës në fshatin Lepenicë të Vlorës, ku u tentua të vritej në banesën e tij 53 vjeçari Lahe Jazaj. Sipas policisë, arrestimi u bë në flagrancë pak çaste përpara se të kryenin vrasjen, në afërsi të fshatit Lepenicë shtetasit: Luka (Rustem) Sherifaj, 42 vjeç, lindur në Varibop të Fierit, dhe banues në Vlorë, i cili kishte marrë 15 milionë lekë nga 56 vjeçari mersin Alliaj; Ledjon Muho, 24 vjeç, lindur dhe banues në Vlorë. Mësohet se arrestimi u krye pas informacioneve të grumbulluara nga Policia në rrugë operative, në momentet kur Luka Sherifaj po kryente veprime konkrete për të ekzekutuar planin e tij për kryerjen e vrasjes. Sipas hetimeve, dyshohet se personi i cili kishte porositur vrasjen është shtetasi Mersin Alliaj 55 vjeç, lindur dhe banues në fshatin Gjorm, kurse objekti i sulmit kriminal ishte shtetasi L.J 53 vjeç, banues në Lepenicë. Ky person, në vitin 2003 ka vrarë me armë zjarri shtetasin Bujar Alliaj (vëllai i porositësit), krim

për të cilin është dënua me 10 vjet burg (dënim i vuajtur). Mësohet se shuma që porositësi u kishte premtuar ekzekutorëve dyshohet të jetë 15 milion lekë në fillim dhe pas kryerjes së krimit do t'u jepte edhe një shumë tjetër. Po ashtu, nga hetimet ka rezultuar se Luka Sherifaj prej disa kohësh vëzhgonte personin që do të vriste dhe


Hetimi
Porositësi u kishte premtuar ekzekutorëve se do t'u jepte para të tjera pas krimit



Ledjon Muho



Mersin Alliaj



Luka Sherifaj



Skema e vizatuar nga vrasësi i paguar, se si do të arratisjes pas kryerjes së krimit

se pas kryerjes së krimit ai do të largohej nëpërmjet zonave malore në afërsi të fshatit, sipas një skice të detajuar që ishte përgatitur më parë nga porositësi. Mësohet se në cilësinë e provës materiale u sekuestruan automjeti "Land Rover" me targa AA 334 DV, një armë zjarri automatik model 56, doreza dhe maska për të mbuluar fytyrën, tuta

kamuflazh, si edhe disa ushqime. Ndërkohë, policia po vijon nga puna për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje, dhe se materialet procedurale do t'i referohen organit të Prokurorisë për Krimet e Rënda Tiranë për veprat penale "Vrasja për gjakmarrje" në bashkëpunim e mbetur në tentative dhe "Armëmbajtje pa leje".

LAJME
shkurt

Kapet me 16 kallëpe eksploziv, pranga të riut

Butë e Pogradecit kanë bërë të mundur sekuestrimin e 16 kallëpe lëndë eksplozive të llojit C4. Sipas burimeve, mësohet se në prangat e policisë ka rënë 28 vjeçari Selajdin Lamli, i cili po lëvizte me makinë të tij "Fiat" me targa AA469 FA, në afërsi të lagjes "1 maji". 28 vjeçari është arrestuar në flagrancë gjatë ditës së djeshme, ku bëhet me dije se policia e Pogradecit kishte informacion për sasinë e lëndës plasëse që Lamli mbante në makinë.



Përplasja e dy automjeteve, s'ka lëndime

Një përplasje mes dy automjeteve ka ndodhur gjatë ditës së djeshme në Tiranë. Ngjarja ndodhi përpara Kryeministrisë, ku një automjet tip "Ford Focus" me targa AA 476 JZ, me drejtues Sokol Vila nga Korça është përplasur me një automjet tip "Fuoristradë" me targa AA 900 EE. Nga përplasja e dy automjeteve, fatmirësisht nuk ka të dëmtuar në njerëz, por vetëm dëmtime të automjeteve. Sipas të dhënave paraprake, shkak i përplasjes ka qenë kalimi i gabuar i automjetit tip "Fuoristradë".

Takimi

FBI sjell specialistë për Byronë Kombëtare të Hetimit

Ministri i Punëve të Brendshme, Saimir Tahiri, gjatë ditës së djeshme është takuar me Zv.Ndihmës Drejtorin J. Chris Earrener dhe Zv.Ndihmës Drejtorin Brian McCauley të FBI, me të cilët ka diskutuar lidhur me forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh në luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme dhe korrupsionit. Ky takim vjen pas vizitës të Ministrit Tahiri në SHBA dhe takimeve që zhvilloi me Zv.Drejtorin e FBI, Mark Giuliano. Që nga dita e djeshme ka nisur puna



konkrete e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Shtetit me ekspertët e FBI për ngritjen e plotë dhe funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ndërkohë, BKH do të shënojë një standart të ri në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të zyrtarëve të lartë.

Gramsh

Krimi në familje. Burri mbyt gruan për motive xhelozie

Krimi në familje trondit banorët e Gramshit. Ngjarja ka ndodhur gjatë ditës së djeshme në fshatin Çekin të Gramshit ku Agron Llapushi ka mbytur me duar në banesë bashkëshorten e tij Alketa Llapushi 35 vjeç, nënë e dy fëmijëve. Sipas të dhënave paraprake, grinda me çiftit dyshohet të ketë ndodhur për motive xhelozie, çka ka bërë që të përfundojë në vrasje. Mësohet, se gjatë grindjes bashkëshorti e ka goditur fillimisht gruan me sende të forta dhe më pas e ka mbytur atë me duar. Ndërkohë, dy fëmijët e çiftit Llapushi



ndodheshin në shkollë në momentin ku ndodhi ngjarja dhe çifti ndodhej i vetëm në banesë. Mësohet se kanë qënë të afermit e Agron Llapushit që e kanë marrë vesh ngjarjen dhe kanë njoftuar menjëherë uniformat blu. Policia e mbërritur në vendngjarje ka bërë të mundur arrestimin e bashkëshortit si dhe ka nisur punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

Policia, aksion për makinat "Shitet"

Policia e kryeqytetit ka nisur punën për lirin e hapësirave publike të zëna nga automjetet të braktitura si dhe zonat si pikë shitje të automjeteve, në zonat urbane dhe interurbane të Tiranës. Strukturat e Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore, Tiranë kanë hartuar plan veprimin për Drejtorinë e Policisë Qarkut Tiranë "Për zbatimin e ligjit dhe lirin e hapësirave rrugore publike që janë zënë e shëndruar në pika shitje për automjetet e reja dhe të braktitura, të parkuara për më shumë se 15 ditë në të njëjtin vend". Kontrolli do të vijojë për 2 javë me rradhë nga ora 09:00 deri në orën 16:00.

**Nishani**

Dy kandidaturat e propozuara nga Nishani për anëtar Gjykatës së Lartë, të cilat "Ligjet" i propozuan Kuvendit mosdhënien e pëlqimit ishin Fuat Vjerdha dhe Markelean Koça.

Halimi

"Qëllimi i mazhorancës është është koherent gjatë gjithë këtyre muajve, qëllim i hapur politik, qëllim për të kapur institucionet e drejtësisë", tha Halimi.

Subashi

Presidenti nuk ka respektuar procedurat dhe kjo ka bërë që situata të thellohet më negativisht. Dhe është konsultuar as me grupet parlamentare", tha Subashi.



Komisioni i Ligjeve

Mbledhja



Komisioni i Mediave miraton projektrezolutën e AMA-s

— Komisioni i Medias ka miratuar në mbledhjen e ditës së djeshme me votat e mazhorancës dhe me votat kundër të opozitës projektrezolutën e AMA për vitin 2014. Gjatë kësaj mbledhje nënkryetari i komisionit Alfred Peza tha se ky institucion nuk i përbushit të gjitha detyrimet që kishte gjatë këtij viti për shkak të vakancave në këtë institucion që u reflektua edhe në pamundësinë e realizimit të projektit për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike. Ky raport u kundërshtua nga demokratët në komisionin, ku sipas deputetit Luciano Boçi AMA ka një drejtues jolegjitim, dhe shqetësimi për procedurën antiligjore të ndjekur nga kuvendi është përcjelle deri në këshillin e Evropës. Demokratët mendojnë se kalimi nga transmetimet analoge në ato numerike nuk u mundësuar për shkaqe klienteliste.

“Ligjet” rrëzojnë dekretet e Nishanit për Gjykatën e Lartë

Halimi: Qëllimi i shumicës, të kap institucionet e drejtësisë

ERMIRA MRRUKU
TIRANE

Komisioni i Ligjeve në mbledhjen e ditës së djeshme me votat e deputetëve të mazhorancës ka propozuar Kuvendit mosdhënien e pëlqimit për dekretet e kreu të shtetit Bujar Nishani, për emërimin e dy emrave që Presidenti ka propozuar si anëtar të Gjykatës së Lartë. Historia e rrëzimit të dekretëve të Presidentit për emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, po vi-

jon në mëse një vit e gjysëm, për shkak të mosmarrëveshjeve mes Presidentit Nishani dhe mazhorancës. Ndërkohë që kandidaturat e propozuara nga Nishani ishin Fuat Vjerdha dhe Markelean Koça, të cilët para dy ditësh patën një seancë dëgjimore në Komisionin e Ligjeve. Arsyet e mospëlqimit të dy emrave të propozuar, shpjeguar relatori i çështje, deputeti Armando Subashi. I cili u shpreh se Presidenti i Republikës nuk ka respektuar procedurat dhe nuk është konsultuar me grupet parlamentare në Kuvend, përpara se të propozonte dy emrat për anëtar të Gjykatës së Lartë. “Presi-

denti i Republikës nuk ka respektuar procedurat dhe kjo ka bërë që situata të thellohet më negativisht. Ndërkohë që Presidenti nuk është konsultuar as me grupet parlamentare në Kuvend, kështu që kërkojmë që dekreti të rrëzohet”, u shpreh deputeti socialist, Armando Subashi, i cili ishte dhe relator i çështjes. Ndërsa kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili duke kërkuar që të rrezohet dekretet e Nishanit, u shpreh se është kërkuar herë pas here Presidentit që të ndërtojë një proces transparent. Ndërkohë që deputeti demokrat Eduard Halimi, ka kundërshtuar qën-

drimin e mazhorancës ndaj dekretëve të kreu të shtetit dhe i ka quajtur qëndrimin e shumicës si “kapje të institucioneve të drejtësisë”. “Qëllimi i mazhorancës është është koherent gjatë gjithë këtyre muajve, qëllim i hapur politik, qëllim për të kapur institucionet e drejtësisë. Votat kundër gjyqtarëve të ndershëm janë vota pro gjyqtarëve të korruptuar. Ligji për Gjykatën e Lartë është bërë në mënyrë të njëanshme ku gjithçka do të bëhet me prezencën qeveritare të ministrit të Drejtësisë që i propozon Presidentit anëtarët e Gjykatës së Lartë”, tha Halimi.

Problematika
TIRANE

Leskaj: Rëra që po përdoret te Lungomare po dëmton bregdetin

“Mos hidhni rërë të kuqe, s’jemi në detin e kuq, jemi në detin jonian”

Deputetja e Vlorës, Valentina Leskaj ka shprehur dje kritika të forta në lidhje me mënyrën me të cilën po bëhen punimet për shëritoren e Vlorës. Në replikën e saj me drejtorin e Fondit shqiptar të Zhvillimit Benet Beci,

Leskaj kërkoj që të mbahet më shumë parasysh dëmet natyreqë po i shkaktohen mjedisit. Pretendimet e deputetes të cilat u shprehën në mbledhjen

e Komisionit për Politikën e Jashtëme, lidheshin me materialin që po përdoret për punimet e këtij investimi të rëndësishëm. Sipas Leskajit, rëra që

po hidhet në Lungomare nuk është aspak cilësor, pasi është i përziera me dheun e kuq që merret nga fshati Xhuhërinë. “Marrin shtufën e Xhuhërinë dhe e hedhin në bregdet te Lungomare. Këtu ka dy probleme. Duhet të dimë që aty ku nisim të ndërtojmë të mos shkatërrojmë, sepse rruga atje është komplet e shatërrar. Unë do t’ju ftoj të shkonit dhe ta shikonit në çfarë gjendjeje është. Së dyti do të doja të theksoja që ajo shtufa dhe ajo rërë nuk është e Vlorës. Bregdeti i Vlorës ka një rërë që të gjithë e dimë. Ajo është një rërë e kuqe e cila shpesh ka ngjyrosur edhe detin. Ndaj dua t’ju them që ne nuk jemi në detin e kuq, ne jemi në detin jonian. Është gjë e mirë që po bëjmë Lungomaren, por jo të shkatërrojmë Vlorën”, deklaroi Leskaj. Sipas deputetes, shqetësimin për këtë ndotje që po i bëhet bregdetit ja kanë përcjellë edhe banorët e zonës të cilët kanë konstatuar ngjyrosjen e detit për shkak të rërës që po hid-



Valentina Leskaj

Mimi Kodheli

Përkujtohet 6 vjetori i hyrjes së Shqipërisë në NATO



Ministria e Mbrojtjes, Mimi Kodheli ka uruar dje shqiptarët për 6 vjetorin e anëtarësimit të vendit në NATO. Me rastin e këtij përvjetori, Kodheli ka përcjellë mesazhe urimi nëpërmjet një statusi në “facebook”. Ministria Kodheli ka shkruar: Shumë urime vendi im i dashur për 6 vjetorin e anëtarësimit në Aleancën e Veriut! Shumë urime i dërgoj edhe Forcave tona të Armatosura në këtë ditë të shënuar për to! Rruga e përbashkët me aleatët dhe partnerët është rruga e sigurisë për të sotmen e të ardhmen e Shqipërisë dhe shqiptarëve”, ka shkruar Kodheli.

SHPLLJE - ANKANDI PER SHITJE SENDI TE PALUAJTSHEM

Studio Ligjore Shërbim Përmbareusi Gjyqësor Privat Eduard Allamani,
me adresë; Lagja Nr.2, Durrës

Në ekzekutim të Urdhër Ekzekutimi Nr.239(988),dt.13/06/2013, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnjë, titullit ekzekutiv, kontratë – kredie Nr.332/1 kol,Nr.785 Rep, dt.30/03/2011, në lidhur midis palës kredidhënëse Fondi Besa Sh.a dhe kredimarrës Luan Cili dhe dorëzanes Lule Cili, zhvillohet ankandi i dytë me datë; 26 mars 2015 deri më datë 27 prill 2015 për shitje të pasurisë:

- me emërtimin truall + ndërtesë (garazh një kat me sip.20 m2), me Nr.pas.22/237, vol.16,fq.121,z.k. 8571, Lushnjë në pronësi të debitorit Luan Sabri Cili. Ankandi i dytë fillon me vlerën 470,400 lekë.

het aty. Ndërkohë që drejtori i Fondit shqiptar të Zhvillimit Benet Beci u shpreh se rëra që po përdoret për Lungomaren ka disa specifika fizike të përcaktuara nga projektuesit, të cilat po respektohen me rigorozitet dhe nuk do të shkaktojnë asnjë lloj ndotjeje në bregdetin e Vlorës.

» ZGJEDHJET

Vendorët, negociatat e PD me aleatët deri më 6 prill

PR presion Bashës: S'tërhiqemi për Dukën, është fitues

ERMIRA MRRUKU
TIRANE

Partia Demokratike ka zhvilluar dje takimin e parë me aleatët në kuadër të zgjedhjeve lokale të 21 Qershorit, ndërsa gjatë takimit nuk u arrit ndonjë marrëveshje konkrete lidhur me këtë çështje. Megjithatë sipas deklaratës së Partisë Demokratike, parimisht koalicioni opozitar do të dalë në zgjedhje me kandidat të përbashkët. Ndërkohë që negociatat mes PD-së dhe aleatëve do të vijojnë deri në datën 6 Prill, ku në përfundim të përfundim të negociatave do të materializohet një marrëveshje parazgjedhore. "Tryeza e koalicionit opozitar shpreh vullnetin politik që bazuar në parimet e transparencës, kolegialitetit, proporcionalitetit dhe bashkëqeverisjes, koalicioni të dalë me kandidatë të përbashkët për kryetarë bashkie në zgjedhjet e 21 qershorit 2015, me objektivi fitoren e këtyre zgjedhjeve. Tryeza e koalicionit të opozitës shqiptare vendosi të zhvillojë negociatat deri me datë 6 prill 2015 dhe bazuar në parimet e sipërpërmendura të materializojë marrëveshje dy palëshe të çdo subjekti të koalicionit me Partinë Demokratike", thuhet në deklaratën e Partisë Demokratike.



Agron Duka dhe Fatmir Mediu

PRESIONI

Gjatë takimit mes Partisë Demokratike dhe aleatëve të saj në opozitë, është vënë re mungesa e kreut republikan Fatmir Mediu, i cili ka adresuar kritika të forta ndaj kreut demokrat Basha, gjatë ditëve të fundit. Kjo sa i përket qëndrimit evaziv që kreut demokrat ka mbajtur ndaj propozimit të republikanëve për kandidimin e Agron Dukës për bashkinë e Durrësit. Megjithatë qëndrimin e PR-së në mbledhje e djeshme e ka përcjellë nënkryetari i kësaj force politike, Arian Madhi. Në prononcimin e

tij për mediat pas përfundimit të mbledhjes në selinë blu, nënkryetari republikan, është shprehur qartë sa i përket propozimit të tyre për kandidaturën e Dukës për Durrësin. Ai tha se PR-ja nuk tërhiqet nga propozimi i saj pasi deputeti Duka është fitues në bashkinë e Durrësit dhe kjo sipas tij është matur edhe nëpërmjet sondazheve të bëra. "Nuk do të kërkojmë bashki, por do të shikojmë se kush kandidat është në krye sipas sondazheve. I qëndrojmë kërkesës për zotin Duka, për ne ai është fitues, sipas sondazheve të qytetarëve të Durrësit. Duka ofron personalitetin më të duhur. Ne do t'i qëndrojmë çdo gjëje në përpunje me parimet", tha nënkryetari republikan, Arian Madhi. Ndërsa ripërsëriti edhe një herë dje deklaratën e dy ditëve më parë, se ka qenë vetë kreut demokrat Basha ai që ka propozuar si fillim kandidaturën e Agron Dukës për bashkinë e Durrësit, duke e parë atë si të vetmin që i sjell fitoren se djathtës në këtë bashki. Megjithatë nënkryetari republikan theksoi se gjatë mbledhjes së aleatëve me kreun e selisë blu, u diskutua mbi parime thelbësore, mbi të cilat mund të ndërtohet një koalicion frytdhënës. "PR parashtrori disa parime si ai i transparencës dhe kolegialitetit. Disa parime që garantojnë fitoren. Do të hyjmë në një proces negociimi pas kësaj", u shpreh Madhi.

Pjesëmarrja

Në takimin e partive opozitare të ditës së djeshme kanë marrë pjesë, nënkryetari i PR-së Arian Madhi, kreu i PDK-së Nard Ndoka, kreu i LZHK-së Dashamir Shehi, kreu i PLL Sulejman Gjana dhe kreu i PLD Arjan Starova.

tij për mediat pas përfundimit të mbledhjes në selinë blu, nënkryetari republikan, është shprehur qartë sa i përket propozimit të tyre për kandidaturën e Dukës për Durrësin. Ai tha se PR-ja nuk tërhiqet nga propozimi i saj pasi deputeti Duka është fitues në bashkinë e Durrësit dhe kjo sipas tij është matur edhe nëpërmjet sondazheve të bëra. "Nuk do të kërkojmë bashki, por do të shikojmë se kush kandidat është në krye sipas sondazheve. I qëndrojmë kërkesës për zotin Duka, për ne ai është fitues, sipas sondazheve të qytetarëve të Durrësit. Duka ofron personalitetin më të duhur. Ne do t'i qëndrojmë çdo gjëje në përpunje me parimet", tha nënkryetari republikan, Arian Madhi. Ndërsa ripërsëriti edhe një herë dje deklaratën e dy ditëve më parë, se ka qenë vetë kreut demokrat Basha ai që ka propozuar si fillim kandidaturën e Agron Dukës për bashkinë e Durrësit, duke e parë atë si të vetmin që i sjell fitoren se djathtës në këtë bashki. Megjithatë nënkryetari republikan theksoi se gjatë mbledhjes së aleatëve me kreun e selisë blu, u diskutua mbi parime thelbësore, mbi të cilat mund të ndërtohet një koalicion frytdhënës. "PR parashtrori disa parime si ai i transparencës dhe kolegialitetit. Disa parime që garantojnë fitoren. Do të hyjmë në një proces negociimi pas kësaj", u shpreh Madhi.

PËRÇARJA

Lulzim Basha e përjashtoi nga zgjedhjet, Doda braktis grupin PD e "dënoi", pasi votoi në Kuvend për arrestimin Frrroku-Doshi




Dashamir Shehi

Pretendimet e shfaqura nga aleatët e opozitës

Aleatët e PD-së i kanë shfaqur pak a shumë pretendimet e tyre për zgjedhjet lokale. Përveç pretendimeve të PR-së, kreut demokrat Nard Ndoka i ka bërë të ditura pretendimet e PDK-së, ku para disa ditësh ka shprehur ambicien që të përfaqësohet në 6 bashki të vendit. Ndërkohë që kreu i LZHK-së, Dashamir Shehi, është i vemti nga aleatët e Partisë Demokratike i cili nuk ka shprehur ambicie për të nxjerrë kandidat për krerë bashkishë por vetëm të jetë i përfaqësuar në këshilla bashkiak.

E dhe pse zgjedhjet lokale po afrojnë dhe situatë e brendshme mes partive duhet të jetë unison dhe pa divergjenca, duket se në Partinë Demokratike kjo nuk po ndodh. Kjo për vetë faktin se tashmë brenda demokratëve ka një krizë e cila herë pas herë del në sipërfaqe, është marrëdhënia e deputetes demokrate Mesila Doda me vendimet e grupit parlamentar demokrat. Kështu pasi kreut demokrat Basha e ndëshkoi deputeten Doda duke e hequr nga kryesimi i shtabit elektoral



në Njësinë 1 në kryeqytet, duke e zëvendësuar atë me nënkryetaren e bashkisë së Tiranës, Nevila Xhindë, deputetja Mesila Doda ka braktisur grupin parlamentar, duke mos u bërë pjesë e mbledhjes që u zhvillua dje në selinë blu. Partia Demokratike vendosi ta "dënojë" deputeten Mesila Doda, pas qëndrimit që kjo e fundit mbajti ditën e enjte në seancën parlamentare, ku qëndroi e vetme në sallë nga opozita për të votuar për heqjen e imunitetit të deputeteve Tom Doshi e Mark Frrroku. Gjatë seancës plenare të ditës së enjte deputetja demokrate

thuhet vendimin e Grupit Parlamentar demokrat për të braktisur votimin për Doshin e Frrkukun, duke u bërë kështu e vetmja nga opozita që votoi për heqjen e imunitetit të dy deputetëve që i hapi rrugë arrestimit të tyre. Ndërkohë ajo që u vu re gjatë mbledhjes së djeshme ishte se përveç deputetes demokrate Mesila Doda, në mbledhjen e grupit parlamentar demokrat nuk kanë marrë pjesë as dy deputetët e PDIU-së, Tahir Muhedini dhe Dashamir Tahiri, të cilët nuk kanë mundur në mbledhjet e mëparshme.

PD-ja do të vijojë negociatat me aleatët e saj në opozitë deri në datën 6 Prill, ndërkohë që PR-ja është e qartë në kërkesën e saj për kandidimin e Agron Dukës për Durrësin



Vendosmëria
"I qëndrojmë kërkesës për zotin Duka, për ne ai është fitues, sipas sondazheve të qytetarëve të Durrësit. Duka ofron personalitetin më të duhur", deklaroi nënkryetari republikan, Arian Madhi.



Vendimarrja

FRD mbledh sot Këshillin Kombëtar për aleancën me PS

— Fryma e Re Demokratike do të mbledhë sot në orën 11:00 Këshillin Kombëtar të partisë, për të marrë një vendim lidhur me ftesën zyrtare që kryeministri Rama ka bërë për t'i bërë pjesë të koalicionit. Kreu i kësaj force politike, ish-presidenti Bamir Topi ka deklaruar se mund të jetë pjesë e një aleance parazgjedhore me Partinë Socialiste, ndërkohë që vendimi final do të merret sot. Në rast marrëveshja, FRD do t'i kërkojë kryeministrit Rama, Bashkinë e Kamzës në të cilën kërkon të kandidojë Ylli Shehun.

2 vjet PS-LSI



SENAD NIKSHIQI
SHKODËR

Kryeministri Edi Rama ka zgjedhur të nis nga qyteti në të cilin krijoi aleancën me kreun e LSI, Ilir Meta, prezantimin e kandidatëve për zgjedhjet vendore. Kreu i qeverisë prezantoi dhe Ketii Bazhdarin si kandidaten e mazhorancës për zgjedhjet vendore të 21 qershorit. Në dy vjetorin e aleancës së tij me Metën, marrëveshje që e sollti në pushtet, Rama përcolli edhe mesazhin e bashkimit për socialistët e Shkodrës pas konflikteve të shfaqura me ish-deputetin Tom Doshi, të cilat sollën edhe përjashtimin e këtij të fundit. Krahas Bazhdarit, Rama prezantoi dhe edhe kandidatët e mundshëm të mazhorancës për bashkitë e tjera të këtij qarku. Kështu për Bashkinë Koplik u konfirmua Tonin Marinaj, në Pukë, Rrustem Struga, për Bashkinë Vau Dejës Gjakë Lleshi dhe për Fushë-Arrëzin Fran Tuci. Përveç konfirmimit të kandidatëve, kryeministri Rama në mbledhjen që zhvilloi me anëtarë të PS-së së Shkodrës foli për herë të parë edhe për arsyet që çuan në përjashtimin e ish-deputetit të Shkodrës, Tom Doshi. Rama la të kuptohej se deputeti që udhëhoqi në 10 vitet e fundit fushatën e PS në Qarkun Shkodër ishte për shkak të sjelljes së tij aspak etike me ministria e drejtorë të

Rama konfirmon Ketii Bazhdarin për bashkinë e Shkodrës

Kryeministri sqaron konfliktin me Doshin: Kur miqësia prish punën unë e prish miqësinë

rëndësishëm të mazhorancës. “Na ka ndodhur një ngjarje e padëshiruar, një ngjarje për të ardhur keq por shumë e rëndë dhe faktikisht ne sot këtu nuk jemi me 4 deputetë

por me 3 deputetë. Për shkak të detyrës me disa më bie që të takohemi e me disa jo por këtu jemi njësoj, jemi pjesë e kësaj familje politike. Historia ka dy pjesë, në njërin pjesë ju

e dini nga zhvillimi i ngjarjes me Tom Doshin dhe në pjesën tjetër pas përjashtimit të Tom Doshit. Pjesa tjetër është pjesa ku unë dua t’ju them dy fjalë. Për fat të keq rreshtimi i Tomës u bë i pashmangshëm për përgjegjësitë të tij sepse në mënyrë të herë pas herëshme krijoi probleme të papëlqyeshme në marrëdhëniet ministria e drejtorë të rëndësishëm. Probleme të natyrave së mungesës së etikës, mungesës së mirësjelljes, sensit të të qënit në publik. Ju e dini që unë nuk e fshih, nuk e kam fshehur dhe nuk kam për ta fshehur që unë kam patur marrëdhënie shumë miqësore por unë kam një kuptim shumë të qartë për miqësinë edhe për punën. Kur miqësia prish punën apo kërcënon të prishë punën, prishet miqësia e nuk prishet puna”, deklaroi Rama. Në mbledhje u vendos që deputeti Namik Kopliku të emërohet kryetar i PS në Shkodër, ndërkohë që Megi Ajtyresa do të jetë pjesë e shtabit të kryeministrit në Tiranë.



LSI

Menjëherë pas konfirmimit të Ramës për kandidimin e Ketii Bazhdarit për Bashkinë e Shkodrës, Lëvizja Socialiste për Integrim ka dhënë pëiqimin e saj për të. Nën kryetari i LSI, Petrit Vasili e ka konsideruar Bazhdarin një kandidatë e shkëlqyer. “Lëvizja Socialiste për Integrim mbështet Ketii Bazhdarin për fitoren e Bashkisë së Shkodrës. Ky qytet e meriton ndryshimin”, tha Vasili



Ketii Bazhdari



Edi Rama dhe Tom Doshi

KANDIDATËT E KOALICIONIT TË MAJTË NË QARKUN E SHKODRËS

- Ketii Bazhdari Bashkia Shkodër
- Tonin Marinaj Bashkia Koplik
- Rrustem Struga Bashkia Pukë
- Gjakë Lleshi Bashkia Vau Dejës
- Fran Tuci Bashkia Fushë-Arrëz

IDRIZI FIRMOS ME PS

Muhedini: Ende s’jemi pjesë e PS, negociojmë edhe me PD

Deputetët e PDIU kërkojnë konfirmimin e strukturave për koalicionin



Kreshnik Spahiu

Bashkimi i PBDNJ e PDIU pa parime, i përfaqësojmë ne

— Kreu i Aleancës Kuqezi, Kreshnik Spahiu e ka konsideruar koalicionin pa parime atë që po arrin të bëjë e majta në të cilin janë bërë bashkë ‘grekët’ e ‘çamët’. Spahiu duke i konsideruar si bashkime të cilat bëhen mbi bazë përfitimesh këto që po bëhen brenda së majtës ka deklaruar se do të jetë pikërisht forca e tij politike ajo që do të bëjë të mundur përfaqësimin e të gjithë të zhgënjyerve nga këto formacione politike.

Marrëveshja e nënshkruar mes kreut të PDIU-së, Shpëtim Idrizi dhe kryeministrit Edi Rama ditën e hënë nuk është pranuar ende nga disa prej deputetëve të PDIU. Kështu deputeti Tahir Muhedini nuk e konsideroi si përfundimtar bashkimin me PS, duke theksuar se më parë do të ketë zhvillim të negociatave mes kryetarit të tij dhe drejtuesve të Partisë Demokratike dhe më pas do të merret një vendim final. “Ne do të negociojmë edhe me PD, dhe pasi të negociojmë edhe me

PD do të kemi të qartë gjithçka. Vendimi i PDIU është që ne të negociojmë me forcat kryesore. Partia jonë ka një program shumë të qartë, është e vetmja forcë që ka një kauzë shumë të rëndësishme që nuk e ka asnjë forcë politike, zgjidhja e çështjes çame. E themi haptas se forcat politike janë ato që e kanë në dorë dhe në do negociojmë si me PS, PD dhe LSI. Kjo forcë politike është krijuar për t’i shërbyer një komuniteti që ka 1 shekull që i mohan idetë e njeriut dhe ky është komuniteti çam. Nga struk-



Tahir Muhedini

turat e shtetit ka 50 vjet që është përjashtuar komuniteti çam. Me demokracinë po japim shembullin që dimë të qeverisim. Ne kemi kapacitetet që t’i shërbejmë vendit. Të 5 deputetët që jemi do të ulemi në një vend bashkë”, u shpreh dje deputeti i PDIU, Tahir Muhedini. Ndërkohë që për kreun e kësaj force politike, Shpëtim Idrizi marrëveshja me Partinë Socialiste është e përmbyllur dhe e vetmja pjesë për të cilën do të diskutohet do të jenë bashkitë që PDIU do të propozojë kandidatë në zgjedhjet vendore.

Vendimi, legalizohen 700 objekte

Qeveria miraton kalimin e parcelave ndërtimore për pronarët

LORENC RABETA
TIRANE

Këshilli i Ministrave ka miratuar dje kalimin e pronësisë së parcelës në favor të 700 ndërtuesve të leje. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, parcelat në fjalë janë të shëprndara në 11 qarqe të vendit. "Shqiptarja.com" publikon sot listën emërore të 700 personave të cilëve u është miratuar e drejta për përfundimin e pronësisë mbi truallin. Në listë sqarohen gjithashtu edhe të dhëna të tjera që i përkasin parcelës ndërtimore, siç janë drejtorja rajonale e ALUIZNI-t ku gjendet parcela,

zona kadastrale, numri i pasurisë, sipërfaqja e parcelës dhe nëse ajo shtrihet në tokë me pronar apo tokë shtet. "Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale për lidhjen e kontratave të kalimit të së drejtës së pronësisë, për parcelat ndërtimore, sipas neneve 83 e 750, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", thekson vendimi i Këshillit të Ministrave. Po ashtu, qeveria përcakton që deri në momentin e regjistrimit të ndërtimit të legalizuar, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paltuajtshme të mos kryejnë ndryshime të gjendjes juridike të pasurive të listuara në këtë

vendim. Po dje Këshilli i Ministrave ka përcaktuar një seri kriteresh të reja për përfshirjen dhe skualifikimin e objekteve në procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje brenda zonave informale dhe jashtë tyre. Sipas përcaktimeve të reja, objektet do të skualifikohen për motive që nisin që nga shkelja e distancave të caktuara nga rrugët, për të shkuar te prania e tyre në territore ndërtimesh publike, kulturore, turistike, e deri te përplasia me planet urbanistike. Objektet pa leje do kualifikohen për legalizim kur kanë, minimalisht, të ndërtuar një kat, si dhe kur në shumë se 50% e sipërfaqes së truallit, mbi të cilin ai ngrihet, disponohet nga poseduesi i këtij ndërtimi informal.



EMRAT E 700 PRONAREVE TE CILEVE U ESHTË MIRATUAR KALIMI I PRONËSISË SE TRUALLIT

Të Dhënat E Vetëdeklaruesit				
Drejtoria	Emri	Atësia	Mbiemri	
2	3	4	5	
Elbasan	Fatmir	Tahir	Sinanaj	
Elbasan	Flamur	Ramis	Selimaj	
Elbasan	Haziz	Osman	Muça	
Elbasan	Shpëtim	Hysni	Dervishi	
Elbasan	Hasan	Kamber	Tafaj	
	Nafije	Mehmet	Haxhihaxhia	
	Flutura	Mehmet	Haxhihaxhia	
	Genitiana	Mehmet	Haxhihaxhia	
Elbasan	Habib	Hasan	Duka	
Elbasan	Mlat	Nazmi	Nuredini	
Elbasan	Alban	Mlat	Nuredini	
Elbasan	Yber	Qemal	Sallu	
Elbasan	Kujtim	Veli	Nergjoni	
Elbasan	Naim	Veli	Nergjoni	
Elbasan	Aqim	Kurt	Nuredini	
Gjrokastr	Mlat	Shëfjet	Maligj	
Gjrokastr	Delan	Tasim	Vedra	
Gjrokastr	Delan	Tasim	Vedra	
Gjrokastr	Albert	Masar	Kulla	
Gjrokastr	Qamil	Fejzo	Çobani	
Gjrokastr	Ferdi	Servet	Dervishi	
Gjrokastr	Kadri	Avni	Bogari	
Gjrokastr	Metë	Abaz	Ismailati	
Gjrokastr	Shahin	Irie	Gaba	
Gjrokastr	Daut	Metat	Pullo	
Gjrokastr	Adem	Ramadan	Basha	
Gjrokastr	Agron	Axhem	Toto	
Gjrokastr	Zykyrt	Abedin	Dëshnja	
Gjrokastr	Bujar	Muharem	Skenderaj	
Gjrokastr	Genitan	Bame	Boci	
Gjrokastr	Eduart	Bame	Boci	
Gjrokastr	Eduart	Bame	Boci	
Gjrokastr	Veziq	Bame	Boci	
Gjrokastr	Kristo	Klanthi	Duvli	
Gjrokastr	Thodor	Jorgo	Millo	
Gjrokastr	Petra	Sevo	Zhapo	
Gjrokastr	Kosta	Harilao	Ksinga	
Tirana 1	Ndoc	Rexhep	Ukacaj	
Tirana 1	Mhill	Zef	Gecq	
Tirana 1	Bujar	Shekij	Mimiri	
	Barje	Shekij	Mimiri	
Tirana 1	Ramadan	Besim	Rama	
Tirana 1	Xhezmi	Kamber	Shehaj	
Tirana 1	Gezim	Shëfjet	Shaqelli	
Tirana 1	Kujtim	Dalip	Toska	
Tirana 1	Fatmir	Isa	Sakollari	
Tirana 1	Gazmend	Xhemali	Shupli	
Tirana 1	Sabri	Shaban	Nuri	
	Iljaz	Sabri	Nuri	
Tirana 1	Xheva	Jonus	Marra	
Tirana 1	Mhill	Prenush	Dedaj	
Tirana 1	Asrit	Mhill	Dedaj	
Tirana 1	Ilir	Mhill	Dedaj	
Tirana 1	Dyber	Bayram	Manaj	
Tirana 1	Bujar	Idriz	Shoku	
Tirana 1	Zeqir	Lahim	Cami	
Tirana 1	Ruzhdi	Musa	Musaj	
Tirana 1	Ndromi	Pilo	Ndreko	
Tirana 1	Qemal	Islam	Mëtrama	
Tirana 1	Xheva	Kadri	Haka	
Tirana 1	Han	Liman	Tusha	
Tirana 1	Hakk	Han	Tusha	
Tirana 1	Selim	Han	Tusha	
Tirana 1	Alfred	Han	Tusha	
Tirana 1	Dritan	Han	Tusha	
Tirana 1	Shkelqim	Han	Tusha	
Tirana 1	Nikoll	Ajdar	Pillati	
Tirana 1	Bashkim	Ramazan	Çelmela	
Tirana 1	Xhemal	Shaban	Muça	
Tirana 1	Perparim	Sherif	Joca	
Tirana 1	Fadil	Ramiz	Qinami	
Tirana 1	Zenel	Islam	Vata	
Tirana 1	Xhevdet	Sabri	Goxhara	
Tirana 1	Muhamed	Rexhep	Rexhepi	
Tirana 1	Beqir	Rexhep	Murashi	
Tirana 1	Arber	Beqir	Murashi	
Tirana 1	Fatmir	Mallig	Sinaj	
Tirana 1	Sulejman	Sherif	Laqç	
Tirana 1	Brunilda	Ferd	Zorba	
	Ardian	Luan	Muçelli	
Tirana 1	Viadmir	Luan	Muçelli	
Tirana 1	Sulo	Luan	Muçelli	
Tirana 1	Egilton	Luan	Muçelli	
Tirana 1	Gezim	Shëfjet	Kodra	
Tirana 1	Qamil	Aslan	Beqari	
Tirana 1	Miranda	Besim	Miqaj	
Tirana 1	Alma	Xhemal	Krasnjqi	
Tirana 1	Qerim	Oqazim	Muça	
Tirana 1	Arjan	Qerim	Muça	
Tirana 1	Hasan	Mehmet	Kajaj	
Tirana 1	Gerti	Hasan	Kajaj	
Tirana 1	Jemin	Hasan	Lila	
Tirana 1	Pjengo	Nikolle	Tarushaj	
Tirana 1	Zenel	Halim	Uklala	
Tirana 1	Astrit	Zenel	Uklala	
Tirana 1	Gezim	Zenel	Uklala	
Tirana 1	Tefte	Ali	Shkupi	
Tirana 1	Ismail	Abdulla	Trimri	
Tirana 1	Fatmir	Idriz	Zeneli	
Tirana 1	Ajshë	Zejnel	Vladi	
Tirana 1	Ilir	Ibrahim	Nazari	
Tirana 1	Xhafer	Ibrahim	Boka	
Tirana 1	Ilir	Damail	Meta	
Tirana 2	Pellumb	Nabri	Cela	
Tirana 2	Fredi	Novrus	Spahiu	
Tirana 2	Zef	Mark	Pershopefa	
Tirana 2	Myzafër	Adem	Gjorela	
Tirana 2	Kristaq	Refik	Lamaj	
Tirana 2	Bukurije	Ibrahim	Zela	
Tirana 2	Blendi	Skender	Hyka	
Tirana 2	Genitana	Skender	Krutani	
Tirana 2	Erver	Haxhi	Dani	
Tirana 2	Alban	Dali	Xhediku	
Tirana 2	Leonard	Thanas	Gjoka	
Tirana 2	Mustafa	Gani	Bici	
Tirana 2	Etherpi	Iraki	Kocq	
Tirana 2	Kujtim	Zurdi	Shehaj	
Tirana 2	Mara	Qendro	Andoni	
Tirana 2	Milorad	Shyngji	Zalta	
Tirana 2	Dashamir	Abdulla	Dede	
Tirana 2	Dudie	Islam	Ndreu	
Tirana 2	Thanas	Dhimitër	Note	
Tirana 2	Xhevat	Brahim	Shimaj	
Tirana 2	Reuf	Shaqir	Xhyheri	
Tirana 2	Baki	Ibrahim	Dervishi	
Tirana 2	Nefide	Abas	Bora	
Tirana 2	Armand	Bardhyl	Bora	
Tirana 2	Elna	Bardhyl	Fazolari	
Tirana 2	Pajtim	Rustem	Zekaj	
Tirana 2	Halim	Mesut	Kosova	
Tirana 2	Kodhel	Taip	Ismailaj	
Tirana 2	Pellumb	Nuri	Zaimi	
Tirana 2	Hidal	Estref	Pula	
Tirana 2	Vislon	Muhamet	Sinaj	
Tirana 2	Fatmira	Qani	Hoxhaj	
Tirana 2	Qani	Jashar	Hoxhaj	
Tirana 2	Artan	Ilia	Gaqi	
Tirana 2	Esat	Hamit	Projko	
Tirana 2	Fadil	Kasem	Fajzo	
Tirana 2	Selaudin	Hernison	Avdia	
Tirana 2	Adem	Shemsi	Durma	
Tirana 2	Aferdita	Bedri	Lazaj	
Tirana 2	Selami	Bayram	Burri	
Tirana 2	Selami	Bayram	Burri	
Tirana 2	Merita	Bektash	Alushani	
Tirana 2	Dritan	Ajli	Alushani	
Tirana 2	Merita	Bektash	Alushani	
Tirana 2	Dritan	Ajli	Alushani	
Tirana 2	Lulzim	Hilami	Sherifi	
Tirana 2	Skender	Hailt	Pasha	
Tirana 2	Qamil	Tofik	Mukaj	
Tirana 2	Xhemal	Mustafa	Kroq	
Tirana 2	Naim	Shaban	Kapllani	
Tirana 2	Dod	Gjete	Dedaj	
Tirana 2	Xhemal	Mustafa	Kroq	
Tirana 2	Naim	Shaban	Kapllani	
Tirana 2	Dod	Gjete	Dedaj	
Tirana 2	Berat	Timothe	Koço	
Tirana 2	Berat	Xheva	Hazi	
Tirana 2	Berat	Sherif	Estref	
Tirana 2	Berat	Estref	Sherif	
Tirana 2	Berat	Pellumb	Shefit	
Tirana 2	Berat	Selman	Isuf	
Tirana 2	Berat	Erver	Isuf	
Tirana 2	Berat	Guxim	Hamza	
Tirana 2	Lezhe	Pjeter	Gjon	
Tirana 2	Lezhe	Dod	Frok	
Tirana 2	Lezhe	Aurel	Gjovallin	
Tirana 2	Lezhe	Mark	Zef	
Tirana 2	Lezhe	Gjergj	Nikoll	
Tirana 2	Lezhe	Age	Gjin	
Tirana 2	Lezhe	Pjeter	Mark	
Tirana 2	Lezhe	Zef	Mark	
Tirana 2	Lezhe	Armando	Mhill	
Tirana 2	Lezhe	Gjin	Martin	
Tirana 2	Lezhe	Nderim	Muharrem	
Tirana 2	Lezhe	Vitor	Geg	
Tirana 2	Lezhe	Simon	Gjin	
Tirana 2	Lezhe	Aleks	Nikoll	
Tirana 2	Lezhe	Ndue	Gjin	
Tirana 2	Lezhe	Ndrec	Ndue	
Tirana 2	Lezhe	Ndoc	Ndrec	
Tirana 2	Lezhe	Mark	Ndrec	
Tirana 2	Lezhe	Dritan	Llesh	
Tirana 2	Lezhe	Agim	Pal	
Tirana 2	Lezhe	Lush	Martin	
Tirana 2	Lezhe	Dilever	Sahid	
Tirana 2	Lezhe	Violeta	Frok	
Tirana 2	Lezhe	Mark	Pjeter	
Tirana 2	Lezhe	Andrea	Gjin	
Tirana 2	Lezhe	Enkelelda	Gjuma	
Tirana 2	Lezhe	Ilir	Hamit	
Tirana 2	Lezhe	Perparim	Hamit	
Tirana 2	Lezhe	Eduart	Lek	
Tirana 2	Lezhe	Mark	Tom	
Tirana 2	Lezhe	Arjan	Xhelal	
Tirana 2	Lezha	Aurel	Pjerin	
Tirana 2	Lezha	Fran	Kol	
Tirana 2	Lezha	Fran	Kol	
Tirana 2	Lezha	Lek	Jak	
Tirana 2	Lezha	Pregng	Pal	
Tirana 2	Lezha	Gjergj	Pregng	
Tirana 2	Lezha	Tonin	Pregng	
Tirana 2	Lezha	Fran	Gjon	
Tirana 2	Lezha	Gjovallin	Nikoll	
Tirana 2	Lezha	Marash	Llesh	
Tirana 2	Lezha	Shkurt	Llesh	
Tirana 2	Lezha	Agime	Ramadan	
Tirana 2	Lezha	Zenel	Shaban	
Tirana 2	Lezha	Naim	Qerim	
Tirana 2	Lezha	Kujtim	Selim	
Tirana 2	Lezha	Afrim	Selim	
Tirana 2	Lezha	Xhevat	Selim	
Tirana 2	Lezha	Sejdi	Shaban	
Tirana 2	Lezha	Gjergj	Martin	
Tirana 2	Lezha	Lazer	Pjeter	
Tirana 2	Lezha	Gjon	Dede	
Tirana 2	Lezha	Nikoll	Mark	
Tirana 2	Lezha	Islam	Begir	
Tirana 2	Lezha	Ismail	Dervish	
Tirana 2	Lezha	Halit	Dervish	
Tirana 2	Lezha	Prenush	Zef	
Tirana 2	Lezha	Nikoll	Prenush	
Tirana 2	Lezha	Ashë	Metush	
Tirana 2	Lezha	Rexhep	Hajdar	
Tirana 2	Lezha	Nesli	Pjeter	
Tirana 2	Lezha	Mark	Kole	
Tirana 2	Lezha	Bashkim	Bayram	
Tirana 2	Lezha	Maliq	Bayram	
Tirana 2	Lezha	Gjok	Pjeter	
Tirana 2	Lezha	Mark	Pjeter	
Tirana 2	Lezha	Ndue	Kol	
Tirana 2	Lezha	Ndoc	Mirash	
Tirana 2	Lezha	Ndue	Kn	
Tirana 2	Lezha	Besnik	Nuh	
Tirana 2	Lezha	Donika	Pandi	
Tirana 2	Lezha	Muhamet	Xhemal	
Tirana 2	Lezha	Ridvan	Fahri	
Tirana 2	Lezha	Merita	Pjeter	
Tirana 2	Lezha	Skender	Teufik	
Tirana 2	Lezha	Jake	Mark	
Tirana 2	Lezha	Gjokë	Mark	
Tirana 2	Lezha	Gaspër	Preli	
Tirana 2	Lezha	Zyfra	Musli	
Tirana 2	Lezha	Sadik	Ahmet	
Tirana 2	Lezha	Angelo	Cosimo	
Tirana 2	Lezha	Zef	Kol	
Tirana 2	Lezha	Shan	Ded	
Tirana 2	Lezha	Aida	Ndoci	
Tirana 2	Lezha	Silva	Kole	
Tirana 2	Lezha	Tom	Nikoll	
Tirana 2	Lezha	Vasel	Pjeter	
Tirana 2	Lezha	Nezir	Musa	
Tirana 2	Lezha	Sulejman	Osman	
Tirana 2	Lezha	Arben	Sulejman	
Tirana 2	Lezha	Mustaf	Ymer	
Tirana 2	Lezha	Suzana	Kole	
Tirana 2	Lezha	Nikoll	Dod	
Tirana 2	Lezha	Avni	Haxhi	
Tirana 2	Lezha	Gjesh	Lulash	

Table with 4 columns: Name, Surname, Location, and other details. Includes names like Dede, Lulash, Preka, Mario, Kofe, Delija, etc.

Table with 4 columns: Name, Surname, Location, and other details. Includes names like Dures, Isa, Ibrahim, Thaci, Gentian, Ferdinand, etc.

Table with 4 columns: Name, Surname, Location, and other details. Includes names like Dures, Andrea, Stefan, Mico, Sotir, Ilo, Loli, etc.

Table with 4 columns: Name, Surname, Location, and other details. Includes names like Fier, Sokol, Ram, Elsi, Kastriot, Vali, Buzi, etc.

Table with 4 columns: Name, Surname, Location, and other details. Includes names like Fier, Pellumb, Ali, Salaj, Altin, Mihallaj, Bubullima, etc.

» ALUIZNI

SKUALIFIKOHEN
ndërtimet në zona turistike,
kulturore, apo që bien ndesh
me planet urbanistike



Shkeljet
Objektet do të skualifikohen për motive që nisin që nga shkelja e distancave të caktuara nga rrugët, për të shkuar te prania e tyre në territore ndërtimesh publike

Ndërtimi informal i llojit "objekt", përjashtohet nga legalizimi kur:

- shkel distancat e lejuara të rrugëve ekzistuese;
- cënon sistemin ose shkel brezin mbrojtës të vijës hekurudhore ekzistuese funksionale;
- është ngritur brenda vijës kufizuese të parcelës ndërtimore të ndërtesave publike;
- është ngritur në zonën e sigurisë së centraleve prodhuese të energjisë elektrike;
- është ngritur brenda zonës mbrojtëse të objekteve të trashëgimisë kulturore;
- zonë-muze, ansambël-muze, qendër historike dhe park arkeologjik;
- zonë arkeologjike "A".
- cënon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës, të kategorisë II;
- është ngritur brenda zonave dhe/ose nënzonave të mbrojtura, apo zonave të ruajtjes së veçantë, shkalla e mbrojtjes të së cilave nuk lejon ndërtime me funksion banimi apo social/ekonomik;
- është ngritur brenda territorit/vijës kufizuese të parcelës ndërtimore të ndërtesave objekt kulti;
- është ngritur mbi ose shkel brezin mbrojtës të tubacionit të gazsjellësit, naftësjellësit, aeroportit, portit apo cënon sigurinë e digave të mëdha, të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi;
- preket nga projektet e infrastrukturës rrugore dhe të sistemeve të linjave energjitike të interkonjeksionit;
- është ngritur brenda distancës në të cilën nuk lejohen ndërtime, nga brigjet e deteve dhe liqeneve, të përcaktuara në dokumentet e planifikimit të territorit, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi

LORENC RABETA
TIRANE

Vendimi: Ja cilat objekte përjashtohen nga legalizimi

Këshilli i Ministrave përcakton kritere të reja për kualifikimin e objekteve dhe sipërfaqeve informale

Këshilli i Ministrave ka përcaktuar dje një seri kriteresh të reja për përfshirjen dhe skualifikimin e objekteve në procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje brenda zonave informale dhe jashtë tyre. Sipas përcaktimeve të reja, objektet do të skualifikohen për motive që nisin që nga shkelja e distancave të caktuara nga rrugët, për të shkuar te prania e tyre në territore ndërtimesh publike, kulturore, turistike, e deri te përplasia me planet urbanistike. "Ndërtimi informal i llojit "objekt", i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar dhe i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, përjashtohet nga legalizimi kur: shkel distancat e lejuara të rrugëve ekzistuese, të kategorive A e B, ose trupin e rrugëve ekzistuese, të kategorive C, D e E, sipas përcaktimeve të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të akteve në zbatim të tij", thekson një prej neneve të miratuara dje nga Këshilli i Ministrave.

"A", apo kur cënon vëllimin ose pamjen e jashtme të monumentit të kulturës, të kategorisë II. Të njëjtin fat objekti pëson dhe në rastet kur është ngritur brenda zonave dhe/ose nënzonave të mbrojtura, apo zonave të ruajtjes së veçantë, shkalla e mbrojtjes të së cilave nuk lejon ndërtime me funksion banimi apo social/ekonomik." Ku preket

nga projektet e infrastrukturës rrugore dhe të sistemeve të linjave energjitike të interkonjeksionit; është ngritur brenda distancës në të cilën nuk lejohen ndërtime, nga brigjet e deteve dhe liqeneve, të përcaktuara në dokumentet e planifikimit të territorit, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi" përcakton Këshilli i Ministrave në vendim.



KUSH PËRJASHTOHE

Përcaktimet e reja përjashtojnë nga legalizimi rastet kur objekti shkel distancat e lejuara të rrugëve ekzistuese apo cënon sistemin ose shkel brezin mbrojtës të vijës hekurudhore ekzistuese funksionale. Përjashtohet gjithashtu edhe çdo objekt që është ngritur brenda vijës kufizuese të parcelës ndërtimore të ndërtesave publike apo është ngritur në zonën e sigurisë së centraleve prodhuese të energjisë elektrike. Kur është ngritur brenda zonës mbrojtëse të objekteve të trashëgimisë kulturore, në zonë-muze, ansambël-muze, qendër historike dhe park arkeologjik, zonë arkeologjike

Objektet pa leje, shitesat anësore/në lartësi, në një ndërtim me leje, në vijim të quajtura "ndërtime informale", kualifikohen për legalizim kur, nga pikëpamja ndërtimore: kanë, minimalisht, të ndërtuar një kat, mbi ose nën tokë dhe janë të ndërtuara me materiale të qëndrueshme, të ngritura, të paktn, në strukturë dhe janë të lidhura pazgjidhshmërisht me tokën. "Kur më shumë se 50% e sipërfaqes së truallit, mbi të cilin ai ngrihet, disponohet nga poseduesi i këtij ndërtimi informal, me dokumentacion pronësie, ose rezultojnë në pronësi shtetërore; pronari i ligjshëm i truallit të zënë shpreh, paraprakisht, vullnetin për heqjen dorë

Në proces përfshihen vetëm objektet që kanë ndërtuar një kat



nga e drejta për të zhvilluar parcelën dhe për trajtimin e tij nëpërmjet kompensimit financiar" përcakton Këshilli

Legalizimet vetëm pas miratimit të pronarit të truallit

Në proces përfshihen vetëm objektet që kanë ndërtuar një kat

ndërtimit që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit, nuk u nënshtrohen procedurave kualifikuese. Për këto ndërtime konstatohet mospërfshirja në procesin e legalizimit, me urdhër të drejtorit të varësisë së ALUIZNI-t, duke argumentuar shkakun ligjor. Drejtoritë e ALUIZNI-t, bazuar në gjendjen faktike në terren, kryejnë procedurat kualifikuese për ndërtimin informal, brenda 60 ditëve nga data e evidentimit faktik në terren (data e "Procesverbalit të evidentimit në terren"). Në rast mosplotësimi, nga subjekti posedues i ndërtimit informal, të dokumentacionit

që duhet të dorëzohet prej tij, brenda 6 muajsh nga njoftimi zyrtar i ALUIZNI-t, ky i fundit informon Inspektoria-tin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për të vepruar, sipas legjislacionit përkatës. Për ndërtimet informale të ngritura brenda zonave dhe nënzonave të mbrojtura si dhe zonave të ruajtjes së veçantë, ku shkalla e mbrojtjes nuk ndalon ndërtimet me funksion banimi ose social/ekonomik, procedurat e kualifikimit kryhen pas depozitimit, nga poseduesi i ndërtimit, të aktit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM), nga një ent apo subjekti i licencuar.

Taksat e energjiasë e karburanteve bie propozimi i PD

Ministri Cani: Opozita e ka diskutuar dhe me FMN, kostot të papërbalueshme për buxhetin

LORENC RABETA
TIRANE

Komisioni parlamentar i ekonomisë rrëzoi dje dy propozimet e opozitës për uljen e taksës së qarkullimit, si dhe për uljen e TVSH-së për energjinë elektrike. Deputetët e djathtë argumentuan në komisionin se ky lehtësim do të ulë barrën e rëndë që paguajnë sot qytetarët, ndër-kohë që Ministria e Financave argumentoi se propozimet kanë kosto të përbalueshme për buxhetin e shtetit, madje rrezikojne ta zhysin në krizë. Ndërsa kujtoi se ulja e TVSH-



Tabaku

Në qoftë se keni forcë ulni taksën e qarkullimit dhe nëse keni moral politik, sot thoni që do të votoni kundër uljes së kësaj takse, se nuk mblidhni dot të ardhurat e tjera

së për energjinë që premtim elektoral i qeverisë, Deputeti i PD Sherefedin Shehu tha se një masë e tillë do t'i vinte në ndihmë sidomos familjeve të varfëra: Grupi parlamentar i PD ka sjellë sot një propozim me të cilin kërkohet që të paktën të ulet apo lehtësohet kjo barrë duke ulur normën e tatimit mbi vlerën e shtuar nga 20 për qind në 6 për qind.

BUXHETI

Nga ana e tij, Ministri i Financave Shkëlqim Cani tha se kostot e uljes së TVSH për energjinë nga 20 për qind në 6 për qind, janë të papërbalueshme për buxhetin e shtetit, ndër-kohë që i një mendimi të tilla ka qenë

NË FOTO:
Komisioni Parlamentar i Ekonomisë



dhe FMN, me të cilën opozita është konsultuar mbi këtë çështje. "Unë besoj fort që opozita në takimin e radhës me misionin e FMN-së e ka trajtuar këtë çështje dhe besoj se ka marrë edhe përgjigje nga Misioni, të cilin do ishte mirë të na e thoshte në këtë tryezë, në mënyrë që marrëdhëniet e ndërkombëtareve të paraqiteshin si marrëdhënie partnerësh seriozë. Paketën fiskale, si duke qënë diçka

shumë serioze e kemi realizuar në konsulta me FMN-në dhe Bankën Botërore. Nuk mjafton vetëm të propozosh këtë masë, por duhet të shohësh edhe kundër efektin dhe të japësh zgjidhje për të.

Të njëjtin fat pati edhe propozimi tjetër i Partisë Demokratike për uljen e taksës së qarkullimit të karburanteve nga 27 në 7 lekë për litër. Deputetja e djathtë Jorida Tabaku akuzoi se Qeveria e ka rritur këtë taksë falë paafësisë për mbledhur të tjerat. "Në qoftë se keni forcë ulni taksën e qarkullimit dhe nëse keni moral politik, sot thoni që do të votoni kundër uljes së kësaj takse, vetëm pse nuk mblidhni dot të ardhurat e tjera. Kjo mbyll çdo lloj diskutimi, e keni të thjeshtë që ta mblidhni taksën e qarkullimit dhe e rrisni" tha deputetja e Partisë Demokratike.

Teuta
Një Mbretëreshë për mikeshë...

Lagja 15, Rruga "Aleksandër Gogo", Durrës- Shqipëri (Albania) Tel.: 052 223094 Fax: 052 22537
info@teutadurres.com www.teutadurres.com

Ligji i ri, studentët në Universitetet në bazë të mesatares

Tre kategoritë e studentëve që do të përfitojnë bursa me ligjin e ri. Ndryshon dhe skema e financimit

DRIÇIM ÇAKA
TIRANE

Këshilli i Ministrave miraton projektligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, i cili ndryshon mënyrën e financimit të universiteteve dhe për herë të parë vendos kritere shtesë për pranimin e studentëve. Sipas ligjit të ri Institucionet publike të arsimit të lartë do të financohen nga Buxheti i Shtetit, nga pagesat e studentëve për arsimin, nga të ardhurat për shërbimet të kryera, të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta, nga donacione dhe veprimtari kërkimore-shkencore. Me ndryshimet në ligj studentët do të pranohen në Universitetet në bazë të mesatares. "Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave", - thuhet në projektligjin për arsimin e lartë, të miratuar djete në qeveri. Sipas komisionit që ka hartuar draftin, Këshilli i Ministrave do të miratojë mesataren dysheme (nga komisioni është propozuar 6) dhe të gjithë maturantët që kanë mesataren e shkollës së mesme poshtë notës dysheme nuk mund të konkurojnë për në Universitet.

Ligji
Bursat e studimit për studentët e shkëlqyer u jepen studentëve me notë mesatare maksimale, në rang vendi, pavarësisht programit të studimit



er. Bursat e studimit për studentët në programet e studimit që përbëjnë prioritet kombëtar. Bursat e studimit për studentët që kanë zgjedhur të ndjekin studimet. Studenti vazhdon të përfitojë nga ky grant nëse rezultatet e tij, gjatë gjithë viteve të studimit, vazhdojnë të jenë të shkëlqyera. Bursat e studimit për studentët që kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit në institucione publike të arsimit të lartë që përbëjnë prioritet kombëtar, u shpërndahen studentëve që studiojnë në fushat e përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të

Ministrave. Bursat e studimit për studentët që u përkasin shtresave sociale në nevojë, u shpërndahen studentëve që janë shpallur fitues në institucionet publike të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret për t'u konsideruar si studentë në nevojë, të përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave. Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë përfshin, fondin për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike dhe fondin e projekteve konkurruese për zhvillimin e institucioneve të arsimit të lartë. Fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor.

Nikolla:



Universitetet që bëjnë sikur japin mësim ka marrë fund

— Menjëherë pas miratimit të projektligjit për arsimin e lartë, ministria e Arsimit Lindita Nikolla është shprehur se me ndryshimet e fundit merr fund koha kur universitetet bënin sikur jepnin mësim. "Ligji i ri për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në arsimin e lartë sjell një mori ndryshimesh, të gjitha në frymën e masave të ndërmarra deri më tani. Ne nuk bëjmë kompromis me cilësinë. Koha e universiteteve që bëjnë sikur japin mësim ka marrë fund. Ky është një ligj për studentët shqiptarë. Një ligj që synon t'u japë mundësinë të rinjve të këtij vendi të fitojnë nga universitetet dije cilësore, të përfitojnë vlerën e munguar të mundit të tyre dhe t'i japin besimin prindërve të tyre, që investimi, koha dhe financat e investuara do t'ia vlejné", - u shpreh Nikolla pas mbledhjes së qeverisë. Gjithashtu ministria e Arsimit theksoi se "ky ligj ndryshon skemën e financimit, duke futur konceptin modern të financimit në bazë të performancës. "Ligji që kaluam sot e bën më të drejtë financimin publik për studentin, duke iu gjendur pranë studentëve në nevojë, duke krijuar një fond të posaçëm bursash për të gjitha kategoritë që për pamundësi financiare nuk ndjekin dot studimet", - përmendi ministria e Arsimit Lindita Nikolla.



ORGANIZATAT

Kopështi Zoologjik një burg për kafshët

— Kështu është cilësuar kopështi zoologjik i vetmi në shqipëri nga organizata "Mother Nature Network", me qendër në Atalanta, SHBA, e cila e klasifikoi kopshin zoologjik të Tiranës në vendin e 6. Kjo qendër ka bërë një klasifikim të kopshteve me kushtet më të këqija në të gjithë botën, ku mbahen kafshët dhe ai i Tiranës është renditur në vendin e 6. Shqetësimi që ngrihet nga organizata "Mother Nature Network" është se përse duhet të mbahet hapur një kopsht i tillë, në këto kushte, kur nuk i shërben asnjë qytetari, madje as vetë kafshëve. "Një kopësht zoologjik si ky që ndodhet në Tiranë nuk u shërben as vetë kafshëve, pasi ai nuk është një vend jetese dhe kujdesi për kafshët për është kthyer në një vend ngordhje për to", - thotë organizata



PROJEKTI

Zyrë për gjetjen e të zhdukurve në diktaturë

— Krahas dëshmipërbimit të të përndjekurve politikë dhe hapjes së dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit, qeveria është angazhuar edhe në gjetjen e të zhdukurve gjatë regjimit komunist, si një detyrim moral ndaj të gjithë shtresë, por në veçanti ndaj familjeve të viktimave që sot nuk kanë një varr. Për këtë qëllim, pranë Institutit të Integritimit të të Përndjekurve Politikë, me mbështetjen e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, do krijohet sektori i të zhdukurve, i cili është projektuar të jetë porta pritëse e të gjitha kërkesave dhe informacioneve mbi procesin e gjetjes së personave të zhdukur gjatë periudhës së diktaturës.

Vendimi
TIRANE

Qeveria rikthen ditën e hënë pushim për administratën

Pelqeshi: Ja kush do përfitojë shpërblime. Miratohet Kodi i Punës

Dita e hënë do të jetë pushim, kur festat zyrtare bien të shtunën ose të dielën. Në këtë mënyrë Këshilli i Ministrave shfuqizon vendimin e 2010-s së qeverisë Berisha. "Duke filluar nga e hëna që vjen, e cila është e hëna pas Pashkëve katolike do të jetë ditë pushimi, si edhe çdo e hënë tjetër që vjen pas ditës kombëtare të pushimit, kur ajo bie në fundjavë", - u shpreh zv.kryeministri Niko Peleshi, i cili konfirmoi se nuk bëhej fjalë për një gënjeshtrë të 1 prillit. Gjithashtu qeveria po punon me një projekt të ri për dhënie e bonusve për nëpunësit dhe punonjësit publikë të shkëlqyer, të cilët



spikasin në punën e tyre. Këto incentive janë financiare, si dhe një sërë incentivash të tjera që tentojnë të korrigjojnë dështimet e tregut të punës

dhe këtu e kam fjalën p.sh për pozicione të cilat mbeten vakante për shkak se nuk janë mjaftueshëmrisht atraktive, siç janë mjekët e speciali-

zuar në spitalet rajonale apo mësuesit e lëndëve të vështira etj", - theksoi Peleshi. Kundërvendimit të qeverisë për të rikthyer të hënën pushim, për festat zyrtare që bien në fundjavë ka dalë deputeti i Partisë Socialiste Erion Braçe. "Sipas këtij vendimi për festa e pushime, java ime e punës është: të hënë pushim, të marte pune, të mërkurë pushim, të enjte sabbatizim, të premte punë në zonë, të shtunë pushim, të dielë pushim!! Sa punë, sa punë!! Po patjetër edhe e hëna pushim!!", - shkruan Braçe në

postimin e tij në "Facebook". Po kështu qeveria ka miratuar dhe ndryshimet në Kodin e Punës. "Punëmarrësi që punon më shumë se 6 orë në ditë duhet të bëjë një pushim jo më pak se 20 minuta, i cili është i nevojshëm për ruajtjen e shëndetit të tij. Koha maksimale javore e punës, së bashku me orët shtesë nuk mund të jetë më shumë se 48 orë dhe maksimumi i orëve shtesë nuk mund të jetë më shumë se 200 orë në vit", - janë disa nga ndryshimet në Kodin e Punës, ndryshime që gazeta i ka publikuar pak ditë më parë

DREJT PUNËS

Suplement i SHQIPTARJA.com

E ENJTE 2 prill 2015 Nr.19

www.shqiptarja.com



Kamariere Restorant Melograno

Restorant Meligrano, kërkon të punësojë personel në pozicionin e mëposhtëm:
Kualifikimet / Kërkesat
Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:
- Të njohe shumë mirë gjuhën angleze dhe italiane.
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikues.
- Të njohe guzhinen italiane.
- Të jete e gateshme te punoje paradite dhe mbasdite.
- Të ketë prezencë të mirë.
- Mosha 20 deri ne 25 vjec.
- Pagine e negociueshme sipas eksperiences.

Koçi: Mjeshtrat, plotësojnë standartet profesionale

Orientimi dhe zgjedhja e degëve të caktuara, sot është një ndër problemet më të mëdha që hasin të rinjtë! Shumë prej tyre synojnë degë të mëdha, si inxhinier, avokat apo ekonomistë, por edhe pse disa kanë arritur të kenë një diplomë sërish janë gjendur përballë vështirësive të tregut, ku profesioni i kamariertit është një ndër më të kërkuarit. Për këtë arsye, Presidentja e Akademisë "Art in food", Ardeta Koçi tregon avantazhet që të rinjtë kanë përmes arsimit profesional dhe kurseve që ata ofrojnë në qendrën e tyre. Në këtë rrëfim, ne kuptojmë se, edhe pse hasim një treg të vështirë dhe plot sfida, shumë

Presidentja e Akademisë "Art in Food" tregon avantazhet

shkolla profesionale kanë mundur të krijojnë urën lidhëse mes të rinjve dhe bizneseve.

"Shoqata e Ushqimit dhe



Projektet janë në fushën e formimit, ku baza është të sjellim standart të ri

Mirëqenies" është ngritur si një risi përsa i përket arsimit profesional. Si lindi ideja e këtij aktiviteti?

Themeluesit e shoqatës kanë vite që janë aktiv në problemet shoqërore-

ekonomike të mjedisit ku jetojmë. Drejtimi themelor i shoqatës është më i madhor dhe kjo është cilësuar mirë në qëllimin e shoqatës, por kuptohet në objektivat tona rëndësi të veçantë i kemi dhënë Arsimit-Profesional. Shqipëria gjithmonë e ka pasur të zhvilluar sistemin e arsimit profesional, prandaj ne me stafet tona të specializuara po përpiqemi të organizojmë tashmë këtë domosdoshmëri që kërkon sot tregu i punës, sipas standardeve europiane.

Çfarë ofron kuzhina në...

lexoni në faqe 17

INTERVISTA/ CHEF FLORI NEZIRI, PREZANTON PROJEKTET E REJA

SITE RUAJME IDENTITETIN E KULINARISE SHQIPTARE

Shefi rrëfen eksperiencën 2-vjeçare në mësimdhënie

NGA IZAUURA NDOJ
TIRANE

Jemi mësuar të shikojmë baret nëpër rrugët e Tiranës të mbushur me të rinj, ku kohën më të madhe e harxhojnë pa asnjë motiv. A është kjo një situatë alarmuese? A mund të krijohet një mundësi punësimi për këta të rinj? A ka ndonjë profesion që sot ka nevojë tregu i punës? Këta dhe shumë pyetje të tjera marrin përgjigje përmes këtij rrëfimi që chef Flori Neziri na ofron në shkollën profesionale "Art in Food" në Tiranë. Pas një eksperience 25 vjeçare nëpër restorantet më të mira në kryeqytet, ai ka gjetur një mundësi të mirë duke motivuar të rinjtë përmes dijeve në kuzhinë duke dhënë mësimdhënie për një periudhë dy vjeçare. Chef Flori...

lexoni në faqe 15



Emiljan Metaj

Kur zanati vlen më shumë se Universiteti

Ai është vetëm 25 vjeç, por zgjedhjen që ka bërë për të pasur një karrierë të suksesshme dhe të paguar në të njëjtën kohë nuk e ka zhgënjyer, madje është krenar që sot ka arritur ti krijoj vetës një mundësi punësimi ndryshe nga shokët e tij. Ky është Emiljan Metaj, ndihmës/kuzhinieri në një nga restorantet më të njohura në kryeqytet, i cili pas një certifikimi në shkollën profesionale "Art in Food" i është krijuar mundësia për të pasur një punë dhe një pagë të mirë ende pa u diplomuar. Madje e ndjen...

lexoni në faqe 18

Chef Flori Neziri: Si të ruajmë identitetin e kulinarisë shqiptare



Aftësimi
Pas një kursi
9 mujor një
kursant fillon
punë direkt
si ndihmës-
kuzhinier.
Madje, edhe
gjatë këtij
kursi ata
punësohen
njëkohësisht



NGA **IZAURA NDOJ**
TIRANË

Jemi mësuar të shikojmë baret nëpër rrugët e Tiranës të mbushur me të rinj, ku kohën më të madhe e harxhojnë pa asnjë motiv. A është kjo një situatë alarmuese? A mund të krijohet një mundësi punësimi për këta të rinj? A ka ndonjë profesion që sot ka nevojë tregu të punës? Këta dhe shumë pyetje të tjera marrin përgjigje përmes këtij rrefimi që chef Flori Neziri na ofron në shkollën profesionale "Art in Food" në Tiranë. Pas një eksperience 25 vjeçare nëpër restorantet më të mira në kryeqytet, ai ka gjetur një mundësi të mirë duke motivuar të rinjtë përmes dijeve në kuzhinë duke dhënë mësimdhënie për një periudhë dy vjeçare. Chef Flori, na tregon rrugën se si përgatiten shefat e rinj për tregun e punësimit.

"Art in food" është shkolla që i afron çdo ditë të rinjtë shqiptarë me kuzhinën dhe traditën shqiptare...si qëndron në këtë raport Chef Flori?

Pas 25 vjet eksperience në disa restorante të mira në Shqipëri në kuzhina të ndryshme (tradicionale, kuzhinë italiane, etj). Kam gati dy vjet që i jam dedikuar mësimdhënies krahas punës si shef kuzhine në "Royal Hill" dhe përgatitjes së kuzhinierëve dhe ndihmës-kuzhinierëve, një profesion për të cilin ka nevojë tregu i punës në Shqipëri dhe jashtë saj. "Art in Food" lindi si domosdoshmëri për kërkesën që ka ky treg. Duke qenë se shumë prindër duan ti japin zanat fëmijëve i dërgojnë mbrapa një shefi apo ustai për të mësuar, ata marrin një zanat, por për të plotësuar këto dije ju duhet një dëshmi apo certifikatë. Prandaj, shumë të rinj hyjnë në kurset e licensuara nga Ministria e Punës sepse vjen momenti që çdo vend pune do të kërkojë dëshminë përkatëse për çdo profesion për tu punësuar si; kuzhinier, kamarier, picier, banakier etj.

Çfarë ofron kuzhina në shkollën tuaj profesionale?

Kuzhina në kurset në "Art in Food" ka një program bazë, ku njihen me bazat e kuzhinës, që nga ambienti, paisjet e rënda, paisjet e imta, uniforma, higjiena personale, higjiena ushqimore, njohja me produktet, ruajtja e produkteve, mënyrën e gatimeve bazë, salat bazë, rupert, brumërat, mishrat, peshqit, të egrat, ëmbëlsira, etj. e recetave specifike që përdoren në restorante në Tiranë. Bazohemi te praktika në laboratorin e klasës duke përdorur materiale reale dhe duke realizuar këto receta, gjithashtu realizojmë edhe praktikë në restorante të ndryshme në Tiranë.

Ku qëndron sukcesi i kësaj shkolle?

Sukcesi i kësaj shkolle qëndron në përkushtimin e të gjithë stafit në një qëllim vetëm, rritjen e cilësisë së shërbimit në fushën e Hotelieri-Turizmit dhe vazhdimësinë e traditës së gatimeve tona.

Kurset janë vetëm për amatorët e kuzhinës, amvisat apo është një shkollë e mirfilltë e gatimeve?

Kurset zhvillohen për n/kuzhinier, kuzhinier, pasticier, picier, kamarier, amvisa apo amatorë, për kuzhinierët që do ju shërbejë si profesion me të cilin jetojnë. Ka një program të mirëfilltë, ndërsa përsa i përket amvisave dhe amatorëve është një program i reduktuar duke i pyetur edhe ata se cilin drejtim intereson të marrin mësim, pra duan të mësojnë



Shefi i kuzhinës rrefen eksperiencën e tij 2-vjeçare në mësimdhënie, përgatitjen e shefave të rinj si dhe tregun e punësimit

receta më specifike apo mënyrat si mund të shtrijnë një darkë për miq. Një risi që po përgatitemi është ngritja e një programi për të bërë kurse për fëmijë, flasin në moshën 8-12 vjeç të cilët mund të marrin orientime drejt të ushqyerit sa më shëndetshëm dhe duke u ushqyer shëndetshëm me të gjitha perimet dhe duke lënë pas picat, makaronat, fast-food, patatina, etj.

E gjejnë të rinjtë veten në këtë ambient?

Të rinjtë e gjejnë veten në këto kurse pasi vijnë nga Shkolla e Mesme dhe në pamundësi për të vazhduar shkollën e lartë zgjedhin një kurs profesional duke u nxitur pak edhe nga prindërit. Ju duket diçka më argëtuese, më e lehtë meqenëse nuk bëhen lëndë të tjera përveç kuzhinës ku më shumë bëhet praktikë se teori. Në fillim vijnë pak si dëshues nëse do të arrijnë të gatuajnë vetë pasi deri në atë moment kanë marrë mamanë apo gjyshen duke gatuar dhe më pas fillon e ju pëlqen kur nga duart e tyre fillojnë e nxjerrin pjatat e para dhe me pas fillojnë e angazhohen. Duke ardhur nga rrethet e shohin si një mundësi për t'ju larguar familjes, por janë raste shumë të rralla, më pas kur këta nxënës largohen në shtëpitë e tyre tregojnë se si në një festë apo drekë festive kanë gatuar për familjet dhe këtë e tregojnë me qejf të madh. Njësoj si ata, kam vepruar edhe unë në fillimet e mija në kuzhinë.

Është e vështirë përgatitja e shefave të rinjve dhe a kanë ego të rinjtë sot për të njohur më shumë traditën e gatimeve shqiptare?

Përgatitja e kuzhinierëve si shef nuk fitohet menjëherë, bëhesh me kalimin e kohës nga eksperiencia dhe bagazhet e njohurive që grumbullohen gjatë jetës. Nuk ka asnjë intuiticion në botë që jep titullin chef, pra nëse dikush në Shqipëri e aplikon këtë titull abuzon. Të gjithë nxënësit që kryejnë kurse të ndryshme 9-mujore marrin njohuri bazë dhe fillojnë punë si ndihmës-kuzhinierë në restorante të ndryshme, përveç atyre që kur fillojnë kursin kanë punuar më parë si ndihmës-kuzhinier dhe i çojnë përpara njohuritë dhe eksperiencën e tyre. Kështu që, pas 3-4 vite eksperiencë do jenë të aftë të marrin përsipër një repart në kuzhinë, e pas 5-7 vitesh mund të marrin drejtimin e një kuzhine. Pra, për të qenë një 'chef' në kuzhinë fillimisht duhet të kalosh të gjitha profilet e punës në një kuzhinë që nga larja e pjatave deri në drejtimin e një kuzhine.

A kemi një kuzhinë të mirëfilltë shqiptare, sepse shpesh etikohet me ndikime të forta nga kuzhina të tjera. Ku bazohen më shumë gjatë orëve të praktikës?

Kuzhina është një alternativë për tregun e punës dhe ka akses, por një kërkesë për këta nxënës që mësojnë është edhe gjuha e huaj, pasi në Lindjen e Mesme ka kërkesa po ashtu edhe në vende të tjera. Kështu që, veç aftësive në pjata si kuzhinier, një kusht i domosdoshëm është edhe gjuha e huaj. Sigurisht që kemi kuzhinë të mirëfilltë shqiptare, pavarësisht se ka ndikime të kuzhinave të huaja nga Ballkani kryesisht, por në zona të ndryshme kemi receta të veçanta ku do të veçoja receta nga Shqipëria e mesme, zona e Dibrës dhe nga jugu, ku kanë tradita të veçanta dhe të pasura me gatime që duhet ti ruajmë për të mos i humbur. Një nga këto qëllime ka edhe shkolla jonë, 'Ruajtjen e identitetit të kulinarisë shqiptare'.

Mendoni se një i ri pas një kursi është i gatshëm të konkurojë për vend pune?

Pas një kursi 9 mujor një kursant fillon punë direkt si ndihmës-kuzhinier. Madje, edhe gjatë këtij kursi ata punësohen njëkohësisht për të mbuluar edhe shpenzimet e kursit.

Cilat janë gatimet që praktikoni më shumë?

Aktualisht gatimet që praktikojmë më shumë janë ato për të cilat restorantet në Tiranë apo bregdet, konsumojnë më shumë pa lënë pas dore edhe tradicionale.

NGA **IZAURA NDOJ**
TIRANE

Orientimi dhe zgjedhja e degëve të caktuara, sot është një ndër problemet më të mëdha që hasin të rinjtë! Shumë prej tyre synojnë degë të mëdha, si inxhinier, avokat apo ekonomistë, por edhe pse disa kanë arritur të kenë një diplomë sërish janë gjendur përballë vështirësive të tregut, ku profesioni i kamarierit është një ndër më të kërkuarit. Për këtë arsye, Presidentja e Akademisë "Art in food", Ardeta Koçi tregon avantazhet që të rinjtë kanë përmes arsimit profesional dhe kurseve që ata ofrojnë në qendrën e tyre. Në këtë rrëfim, ne kuptojmë se, edhe pse hasim një treg të vështirë dhe plot sfida, shumë shkolla profesionale kanë mundur të krijojnë urën lidhëse mes të rinjve dhe bizneseve.

"Shoqata e Ushqimit dhe Mirëqenies" është ngritur si një risi përse i përket arsimit profesional. Si lindi ideja e këtij aktiviteti?

Themeluesit e shoqatës kanë vite që janë aktiv në problemet shoqërore-ekonomike të mjedisit ku jetojmë. Drejtimi themelor i shoqatës është më madhor dhe kjo është cilësuar mirë në qëllimin e shoqatës, por kuptohet në objektivat tona rëndësi të veçantë i kemi dhënë Arsimit-Profesional. Shqipëria gjithmonë e ka pasur të zhvilluar sistemin e arsimit profesional, prandaj ne me stafet tona të specializuara po përpiqemi të organizojmë tashmë këtë domosdoshmëri që kërkon sot tregu i punës, sipas standarteve europiane.

Cfarë ofron kuzhina në shkollën tuaj profesionale, cilat janë elementet që e plotësojnë atë?

Qendra jonë me moton "Mundësi për të Gjithë" në objektivin e saj ka alternuar rrjedhshëm teorinë me praktikën, ka ndërthur marrëdhënie shumë të ngrohta me kursantët referuar etikës profesionale, pedagogët kanë eksperiencat që i dallon nga qendrat e tjera, ambientet realizojnë më mirë zhvillimet mësimore. Të gjitha këto sëbashku formojnë elementet bazë për një standart profesional dhe këto hapa na kanë sjellë rezultate pozitive në qendrën tonë.

Cilët kategori janë orientuar më shumë drejt kuzhinës?

Qendra jonë ka prezantuar programe krejtësisht të kuptueshme e plotësojnë më së miri kërkesat e kursantëve. Tregu jonë i punës fatkeqësisht nuk është i orientuar dhe kjo vështirësi shumë punën tonë, por në marketingun tonë jemi mundur të përfshijmë të gjitha kategoritë. Them se, kategorija më kërkuese janë të rinjtë që duan të përfillojnë një zanat ose më mirë një profesion, pataj hyjnë ata kursantë që kanë në biznesin e familjes 'kuzhinën', e më pas vijnë dhe ajo kategori që është më e pakët që duan të mësojnë kuzhinën.

Cili është qëllimi i shoqatës tuaj



Ardeta Koçi: Mjeshttrat, plotësojnë standartet profesionale

Presidentja e Akademisë "Art in Food" tregon avantazhet që të rinjtë kanë përmes arsimit profesional



Projektet

Projektet tona janë kryesisht në fushën e formimit, ku projektet bazë është që të sjellim një standart të ri

Orjentimi

Tregu jonë i punës fatkeqësisht nuk është i orientuar dhe kjo vështirësi shumë punën tonë, jemi mundur të përfshijmë të gjitha kategoritë



dhe ku konsiston ai?

Në qëllimin e saj shoqata do të ketë analizimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kulturore, profesionale dhe morale të anëtarëve të saj dhe të të gjithë atyre që marrin pjesë në promovimin e investimeve. Të punojë për arritjet e shoqërisë shqiptare të frymës së përgjegjësisë ndaj individit, komunitetit, traditave kulturore dhe mjedisit.

Themeluesit e Shoqatës, pa marrë parasysh besimin, ngjyrën, moshën, idetë, do të jetë e gatshme të ndihmojë, të këshillojë, të zhvillojë për arsimimin e përgjithshëm dhe atë profesional. Këto dhe shumë objektiva të tjera plotësojnë qëllimin e formimit tonë që në thelb është shërbimi dhe ndihma profesionale për komunitetin.

Është kjo një mundësi për të ndihmuar dhe ruajtur mjedisin social kulturor, natyror si dhe prezantimin e vlerave të turizmit në Shqipëri?

Së bashku po përpiqemi të ruajmë, të sjellim në nivelet më të larta traditën shqiptare. Kuptohet që ngritja nuk vjen vetëm me një lule, prandaj filozofia jonë është sa më shumë lule të freskta e të bukura do të na bëjnë një buqetë të bukur, që e ka emrin Shqipëri.

Shumë shkolla profesionale në Tiranë nuk kanë arritur të krijojnë urën lidhëse me bizneset për t'iu dhënë një mundësi punësimi më të mirë të rinjve. Ju si e keni zgjidhur?

Shqip dhe thjeshtë, janë këputur hallkat e zinxhirit dhe biçikleta s'ka si të eci. Duhet akoma shumë punë për të lidhur këto hallka. Për ne, kjo është një temë që duhet të ul në tavolina pune, qendrat, shkollat, sipërmarrjet. Në dukje, qeveria e ka liberalizuar arsimin profesional, por në vetvete kontrollon qendrën më të madhe në shqipëri. Sot për sot, për ne është konkurrenca kryesor.

Në zgjidhjet për punësimin i kemi gjetur vetëm nëpër rrugët e miqësisë dhe reklamave që bëjnë sipërmarrjet.

Tregu i punës sot sa vjen dhe vështirësohet përse i përket konkurrencës. Me kurset që ju realizoni përgatitni të rinjtë që të jenë konkurent në treg?

Edhe pse hasemi në një treg të vështirë, deri më tani kemi gjetur mirëkuptime falë eksperiencave të mjeshtreve të kuzhinës që kanë kontribuar për mundësimin e punësimin të kursantëve.

Nga kush preferohet më shumë kuzhina nga meshkujt apo femrat? Interesante! Besoj se meshkujt janë ato që janë orientuar më shumë drejt kuzhinës.

Cilat janë projektet që shoqata juaj ka në vazhdimësi?

Projektet tona janë kryesisht në fushën e formimit, ku projektet bazë është që të sjellim një standart të ri, çdo punëmarrës duhet të pajiset me certifikatën e profesionit. Shpresojmë që sëbashku me qendrat e tjera, në konsultim me partnerin shtet të vendosim këtë standart.

Oferta Punësimi

Përkthyes/e i/e Gjuhës Franceze

Communication Progress Sh.p.k, ofruar zgjidhesh të integruara në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit-TIK, është duke kërkuar një kandidat/e të përshatshëm për pozicionin "Përkthyes/e i Gjuhës Franceze"

- Detyrat
- Përkthimi i materialeve frëngjisht-shqip dhe anasjelltas
 - Komunikim i vazhdueshëm me folës të lindur të frëngjishtes Kualifikimet / Kërkesat
 - Të ketë mbaruar Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Dega Frëngjisht
 - Të ketë eksperiencë në përkthime të shkruara dhe të folur të frëngjishtes për biznes
 - Të ketë njohuri themelore të fjalorit frëng teknik të informatikës dhe programeve informatike
 - Të ketë aftësi për të përkthyer me korrektesë diskutime teknike
 - Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze (lexim dhe shkrim)
 - Të ketë njohuri themelore në përdorimin e paketës MS Office (Word, Excel, Poëter Point)
 - Të jetë profesional dhe tepër i komunikueshëm, i aftë të punojë në ambient dinamik dhe bashkëpunues.
 - Të jetë i përkushtuar e korrekt. Shënime
 - Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë nepërmjet duapune.com ose te dërgojnë aplikimin e tyre tek: rekrutime@commprog.com



Inventarizuese Balkan Sport SH.PK (Adidas & Reebok)

Kompania Balkan Sport Shpk, distributori zyrtar i Adidas dhe Reebok në Shqipëri, kërkon të punësojë: Inventarizues

- Detyrat
- Kontroll peridiorik i gjendjes së artikujve të dyqaneve, brënda afateve kohore të caktuara.
 - Numërim dhe verifikim fizik i diferencave të inventarit. Kualifikimet / Kërkesat
 - Diplomë Universitare, avantazh të diplomuarit në fakultetin Ekonomik.
 - Të ketë njohuri të Paketës Office.
 - Të jetë e motivuar, e besueshme dhe me dëshirë për të punuar.
 - Bashkëpunim me stafin në lidhje me mbarëvajtjen e punës.
 - Të ketë etikë në punë.



Kur zanati vlen më shumë se Universiteti

N/kuzhinieri Emiljan Metaj;
Zgjedha kuzhinën për të ndjekur ëndrrën time

■ Filimet
"Me kuzhinën jam prezantuar që 14 vjeç ku kam mbaruar dhe shkollën Hoteleri-Turizëm në Durrës", tregon gjithë entuziazëm Emiljano

Ai është vetëm 25 vjeç, por zgjedhjen që ka bërë për të pasur një karrierë të suksesshme dhe të paguar në të njëjtën kohë nuk e ka zhgënjyer, madje është krenar që sot ka arritur ti krijoj vetës një mundësi punësimi ndryshe nga shokët e tij. Ky është Emiljan Metaj, ndihmës/kuzhinieri në një nga restorantet më të njohura në kryeqytet, i cili pas një certifikimi në shkollën profesionale "Art in Food" i është krijuar mundësia për të pasur një punë dhe një pagë të mirë edhe pa u diplomuar. Madje e ndjen veten një konkurrent në treg edhe pse nuk ka një diplomë Universiteti. Ai kujton se lidhjen me kuzhinën e ka pasur që në moshë fare të vogël, i ndikuar nga familja e ka bërë ta afrojë akoma më shumë me traditën e kuzhinës shqiptare. "Me kuzhinën jam prezantuar që 14 vjeç ku kam mbaruar dhe shkollën Hoteleri-Turizëm në Durrës", tregon gjithë entuziazëm

Emiljano. Ai kujton se, çdo fillim ka vështirësitë e tij, sidomos kur nxënësit njihen me produktet themelore, por në praktikë ndodh e kundërta.

"Unë kam dajën që është kuzhinier dhe duke qenë se shkoja shikoja vazhdimisht kur ai punonte, aty nisi dhe ajo lidhja ime me kuzhinën dhe gatimet. Vit pas viti duke qenë më afër praktikës, vendosa t'i hyja këtij zanati, ku veç gatimeve tradicionale, herë pas herë eksploroj edhe ndërthurje të kuzhinave të huaja".

MË SHUMË SE NJË DIPLOMË

Shpesh të rinjtë mendojnë se një diplomë Universitare është zgjidhja e kësaj vorbulle që tregu shqiptar të ofron. Dhe shpesh shtrojmë pyetjen. A është profesioni i duhur që ne zgjedhim? Këta përgjigje na i tregon Emiljano, i cili edhe pse ndikimin për të pasur një zanat e ka marrë që në fëmijëri, ai sot veç aftësive që ka marrë ka dhe një pagë të konkurrueshme në treg. "Si çdo profesion ka dhe ai vështirësitë e veta dhe ndahet në kategori dhe në bazë të njohurive, por paguhet dhe

paguhet mirë do të thojë", thekson Emiljano. Sot, thotë ai takon shumë miq dhe shokë fëmijërie të cilët kanë një diplomë të Shkollës së Lartë, por nuk gjejnë dot punë as kamarier. "Nuk më duket aspak normale që të mbarosh një shkollë të lartë dhe të mos gesh punë në profesionin tëndë. Zanatin e shikoj si një zgjidhje për të rinjtë që duan të kenë jo vetëm një karrierë të suksesshme, por edhe të ardhura normale për të mbajtur një familje".

ZGJEDHJA E DUHUR

Të kesh një zanat, do të thotë të kesh një mundësi punësimi. Nën këtë moto, kemi parë shumë vajza dhe djem të rinj që sot kanë mundur ti rezistojnë tregut të punës në kryeqytet. "Nëse ti ke pasion, vullnet dhe dëshirë për të punuar në çdo profesion, atëherë ti vlen", kështu e cilëson Emiljano i cili synon të shkojë më lart në karrierën e tij si kuzhinier. Ai nuk harron të thotë se, kuzhina në radhë të parë është art, ofrtë ajo tradicionale apo shqiptare, mjafton të kesh ide për të befasuar klientin.

■ Motoja
Të kesh një zanat, do të thotë të kesh një mundësi punësimi. Kemi parë shumë vajza dhe djem të rinj që sot kanë mundur ti rezistojnë tregut të punës në kryeqytet

Oferta Punësimi

Inxhinier Elektrik/ Elektronik ABIESSE

ABi Esse, kompani që operon në fushën e tregimit të materialeve elektrike, njofton pozicione të lira për Inxhinier Elektrik/ Elektronik.

Të interesuarit të dërgojnë CV-në e tyre në adresën e-mailit info@abiesse.al, duke specifikuar pozicionin për të cilin aplikon. Kualifikimet / Kërkesat

1. Të jetë i diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë, Dega Inxhinieri Elektrike ose dega Inxhinieri Elektronike
2. Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë në këtë fushë
3. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe italiane

Shënime

Të interesuarit të dërgojnë CV-në e tyre në adresën e-mailit info@abiesse.al duke specifikuar pozicionin për të cilin aplikon. CV duhet të shoqërohet me listën e notave dhe certifikatat përkatëse.

Menaxher Projekti/ Unipress shpk

Kompania "Unipress shpk" e pozicionuar si lider në fushën e shtypit të shkruar dhe që realizon: Gazetën Shekulli, Botimet Max, Revistën "Bota në Vitin 2015" kërkon të punësoshë "Manaxher Projekti".

Detyrat

Qëllimi i përgjithshëm i këtij pozicioni është manaxhimi i suksesshëm i projektit/ eve duke sjellë efektivitet në kosto, cilësi dhe afat të lëvrimit.

-Të jetë diplomuar në arsimin 4 vjeçar ose 5 vjeçar me rezultate të shkëlqyera.

-Të ketë eksperiencë pune në fushën e manaxhimit të projekteve në ndonjë OJQ, organizatë, ose shoqëri private për më shumë se 2 vjet.

-Të ketë njohuri të shkëlqyera në shkrim, lexim dhe komunikim të gjuhës angleze, gjuhë të tjera përbëjnë avantazh konkurrues për kandidatët.

-Të zotërojë aftësi të shkëlqyera menaxheriale dhe punës në grup.

-Kryen përpilimin e planit të projektit;

-Menaxhon grupet e interesit;

-Menaxhon komunikimin midis paleve;

-Menaxhon kohën e projektit;

-Menaxhon buxhetin e projektit;

-Të ketë ambicje për karrierë.

-Të jetë serioz, punëtor dhe i përgjegjshëm.

-Të jetë i komunikueshëm dhe fleksibël.

KURSET "ART IN FOOD"

ADRESA: Rruga Meleq Gosihtit, 1002 Tirana, Albania. info@artinfood.al



▶ Ndhimës-kuzhinier
Nga: AKSH
Koha: 3 muaj
Ore: 96 ore
Grupi: 15-20 persona
Cmimi: 20.000 leke/muaj



▶ Kuzhinier
Nga: AKSH
Koha: 6-9 muaj
Ore: 802 ore
Grupi: 15-20 persona
Cmimi: 25.000 leke/muaj



▶ Shef/kuzhinier
Nga: AKSH
Koha: 18 muaj
Ore: 1440 ore
Grupi: 10 persona
Cmimi: 15.000 leke/muaj


▶ Pasticier
Nga: AKSH
Koha: 6-9 muaj
Ore: 802 ore
Grupi: 10-15 persona
Cmimi: 25.000 leke/muaj



▶ Shef/Pasticier
Nga: AKSH
Koha: 18 muaj
Ore: 1440 ore
Grupi: 10 persona
Cmimi: 15.000 leke/muaj



▶ Picaberes
Nga: AKSH
Koha: 2 muaj
Ore: 96 ore
Grupi: 15-20 persona
Cmimi: 20.000 leke/muaj



Ligje farsë apo të vërteta?



NGA **FATMIR MERKOÇI**

vijon nga faqja 1

Intriga e politikës ka arritur deri aty sa, në mënyrën më të pacipë, kërkojnë që dekriminalizimi të bëhet me ligj.

Pyetja më lind vetëvetiu. Përse duhet ky ligj?

Dihet mjaft mirë tashmë se emërimet për deputet, funksionar të lartë të shtetit, i bën kryetari i partisë. Edhe punonjësit e administratës po partia i emëron. Kryetari dhe partia janë ata që zgjedhin dhe caktojnë kandidatët, pra janë ata që duhet ta ndalojnë idividin e inkriminuar që të bëhet pjesë e listave të vetë ata bëjnë. Në këto kushte, ligji del jashtë funksionit të tij. Mirëpo kryetarët dhe partitë e dinë mjaft mirë se sa borxhe u kanë këtyre njerzve të inkriminuar. Këta njerz janë ata që mbulojnë fushatat, janë ata që fusin duart dhe në kutitë e votimit. Janë ata që blejnë dhe komisionerët, pra janë bërë domosdoshmëria e çdo partie. Kërkesa për të miratuar një ligj për këtë çështje tregon hapur se krimelët janë bërë pjesë integrale e politikës shqiptare. Kjo vërteton se partive dhe kryetarëve u duhet një ligj për t'i anashkaluar këta njerz. Them për t'i anashkaluar, pasi këta njerz janë bërë pjesë integrale e partive dhe, si pasojë, edhe e politikës shqiptare.

Mesa duket, partitë nuk kanë forcë për t'i larguar.

Po e keqja nuk mbaron edhe nëse miratohet ky ligj. Kjo kategori njerzish do të mbetet brenda partive. Do të kalojnë në skalionin e dytë, duke emëruar besnikët e tyre. Kjo do jetë edhe më e rrezikshme. E them këtë, pasi nuk do ketë më asnjë arsye për t'i drejtuar gishtin një deputeti, ministri apo funksionari të lartë si njeri të inkriminuar.

Ky ligj do të jetë një fasadë e shëmtuar për të treguar se politika e administrata u spastrua pas tij. Morali në këtë rast duket se nuk ka asnjë funksion në politikën shqiptare.

DEKUMUNISTIZIMI

Një tjetër çështje që ka hapur debat. Edhe për këtë kërkohet një ligj. Ndryshe nga dekriminalizimi, në dekomunizim përfshihet ligji i lustracionit, si dhe ai i dosjeve. Nëse i marrim veçmas, shohim se të gjitha postet shtetërore, politikën, pushtetin gjyqësor, e ka pushtuar ish-nomeklat-ura e vjetër ose pasardhësit e tyre.

Nëse për dekriminalizimin Kuvendi e miraton ligjin me dakortësinë e të gjitha palëve, për dekomunizim nuk mundet ta gjejë, pasi pjesa më e madhe e deputetëve duhet të largohen nga politika, administrata shtetërore, Gjyqësori, shoqatat etj. Pyetja bëhet më e thjeshtë: A mundet që këta njerz të bëjnë një ligj për të larguar veten e tyre? Kjo është, sa paradoksale, qesharake, aq dhe hipokrite. Tashmë duket qartazi se askush nga këta nuk është i interesuar për këtë ligj.

Aktualisht, mazhoranca, e cila i ka votat, nuk mundet ta bëjë, për vetë prejardhjen e saj. Opozita, duke e ditur se ligji nuk ka gjasa të miratohet, nxjerr pretendimin e ndryshimit kushtetues. Këtu hyn në lojë ligji tjetër, ai i dosjeve.

HAPJA E DOSJEVE

U bë më se një çerek shekulli që



për hapjen e dosjeve të Sigurimit të Shtetit flitet e përfillet. Çudia është se kërkesën për hapjen e dosjeve e ka bërë gjithmonë opozita dhe, kur bëhet pozitë, ajo hesht për këtë ligj. Kjo është kthyer në një lojë fëmijësh "e ka kush e ka". Hapja e dosjeve e bashkëpunëtorve të Sigurimit nuk kërkon vetëm ligj, vullnet politik. Ajo kërkon moral. Po si mundet të flitet për moral me të pamoralshmin? Nëse në politikën shqiptare do të ekzistonte morali, sot nuk do të ishim në këtë diskutim. Shohim se dhe me këtë ligj po luhet e po kërkohet që të jetë një ligj fasadë. Them kështu, pasi vetë ligjvënësit tanë kërkojnë që të marrin copa ligjesh sa andej-këndej, duke e kopërkthyer dhe duke e quajtur si ligj evropian. Në fakt, nuk është asgjë më shumë se sa një paçavure shqiptare.

Shqipëria ka kapacitetet e saj. Ne mundemi dhe duhet t'i bëjmë vetë ligjet tona. Kjo do të bëjë që dhe kuptimi, interpretimi dhe zbatimi i tyre të jetë real dhe funksional. Në të gjitha rastet kur ligjet kanë ardhur si pasojë e importit të tyre, gjithmonë

ka pasur e ka probleme. Kjo gjë është e dukshme që me ligjin themelor të vëndit, Kushtetutën, nga e cila buronj të gjitha ligjet e tjera.

Politikës sonë nuk i intereson as dekriminalizimi, as dekomunizimi, as lustracioni e as hapja e dosjeve. Politikës dhe atyre që e kanë privatizuar dhe e kalojnë me trashëgimi tek pasardhësit e tyre, i interesojnë ligjet e pazbatueshme. Ata duan ligje vetëm për të thënë se kemi ligj. Për të trumbetuar se "e bëjmë spastrimin e politikës dhe administratës shtetërore, tashmë askush nuk mundet të na gjykojë e aq më tepër të na akuzojë për gjëra të tilla".

Të hapësh dosjet do të thotë që njerzët e përfshirë në to të kërkojnë falje publike, t'u kërkojnë ndjesë viktimave të tyre. Por dhe fëmijët apo familjarët e tyre duhet të distancohen nga prindërit apo familjarë, të cilët janë pjesë e këtij grupimi, duke i dënau veprimet e tyre. Të largohesh nga politika, administrata, Gjyqësori dhe nga çdo veprimtari që ka të bëjë me interesin e publikut, kërkon

ndërgjegje dhe qytetari. Sigurimsat nuk e kanë një gjë të tillë, pasi, po ta kishin, nuk do të ishte nevoja e hapjes së dosjeve. Nuk do të kishte nevojë të investohej për të zbuluar sigurimsat. Duke parë me gjakftohtësi këto nisma, them se më shumë kemi të bëjmë me një propagandë mediatike, me një lumë akuzash të ndërsjella politike, se sa me bërjen e një ligji të zbatueshëm. Dosjet e Sigurimit kanë dhe pozicionet e tyre. Në periudhën e diktaturës dihet se partia ishte mbi të gjithë, pra dhe mbi Sigurimin. Ndoshta dosjet e komiteteve të Partisë së Punës janë më kompromentuese se vetë dosjet e Sigurimit. Askush nuk flet për këto dosje. Askush nuk thotë se përse për këto dosje heshtet! Ligji për arkivat e ka tejkaluar afatin e tij ligjor, çka do të thotë se ligjërisht asgjë nuk e pengon një gjë të tillë.

LIGJI DHE MORALI

Janë hedhur mjaft projektligje për këtë çështje. Janë marrë modele të shteteve të ndryshme, kryesisht të atyre gjerman e italian. Çudia më e madhe ndodh se nuk merr mendimi i asnjë shqiptari, i asnjë shtrese shoqërore, aq më tepër e shtresës, e cila në atë kohë quhej "e dekluar". Me këtë ligj, çuditërisht, merren ata, që nuk kanë gënë të prekur nga fenomeni, merren ata, të cilët, pas miratimit të tij, mundet të rezultojnë me dosje. Në këtë këndvështrim, ky ligj nuk mundet të jetë një ligj që pastron politikën, administratën, Gjyqësorin etj. nga kjo situatë.

Duke parë e analizuar në tërësi problemin, na lind e drejta të themi se çështja është më e lehtë për t'u zgjidhur. Ligji formulohet duke marrë në konsideratë, doket, zakonet, traditën, sipas gjëndjes shoqërore e zhvillimit të vetë kohës. Ligji nuk është tabu. Ai bëhet i zbatueshëm atëherë kur vetë ligji kthehet në ligj moral. Tek ne kjo mënyrë e ligjit nuk njihet. Tek ne njihet vetëm ligji i cili bëhet vetëm për të përbushur disa kritere të Europës dhe jo në pak raste ligji bëhet dhe për të luftuar kundërshtarin politik. Ka ardhur koha që shqiptarët të shohin një ligj dhe një zbatim të tij, jo si hakmarrje, por si zbatim i një të drejte të mohuar prej më shumë se dy dekadash. Shpresa vdes e fundit!...



BLOG PERIFERI



NGA **ALBA MALLTEZI**

Vetmia e njerzve të mirë

vijon nga faqja 1

Kush në të vërtetë kërkon të respektojë rregullat, të punojë ndershëm, të ndjekë të vërtetën stonon, përjashtohet, mbetet vetëm. Ka ndodhur dhe të vritet, si në rastin e komisar Dritan Lamajt.

Si sot e kujtoj kur një mike, një vajzë e drejtë dhe ëndërrimtare, e cila punonte në administratën shtetërore erdhi në redaksi dhe më tha: "Dua ta denoncoj ministrin tim, po bën korrupsionet më të mëdha që mund të imagjinohen. Nuk mund të hesht ndërkohë që ky individ rrëmben çdo gjë dhe punon vetëm për vete".

Mikesha ime e mirë e la punën në administratë, por në redaksi nuk erdhi më të denonconte ministrin e saj që e kishte menduar njeri me moral të lartë.

Sot ai ministër është ndër politikantët më të njohur, jep mend, shet moral e libra. Atij asgjë nuk i ka ndodhur, përkundrazi, është shpërblyer nga shoqëria dhe sistemi ynë i drejtësisë dhe shtetformimit me një jetë komode dhe mirëqenie të siguruar gjatë.

Por unë mendoj, edhe nëse mikesha

ime do të dilte në TV dhe do të bërtiste me të madhe se kishte fakte, ishte dëshmitare, kishte parë korrupsionin, sistemi i amortizimit të skandaleve do të veprime me shpejtësi dhe jashtë sistemit do të mbetet sërish mikesha ime dhe jo ish-ministri, sot politikan "në modë".

Këto ditë mbi zyrtarë të Shtetit bie dyshimi i madh për fshehjen e një urdhër arresti nga autoritetet belge për deputetin Mark Froku. Kush e ka fshehur? Kush e ka ditur dhe nuk ka folur?



Kush ka heshtur? Përse? Komisar Dritan Lamaj kishte kërkuar informacione nga Interpol Tirana më 2012 dhe si pengë mori humbjen e jetës. Shteti e tradhëtoi tre vite më parë, ëndërrim të mos e ketë tradhëtuar edhe tani. Komisar Lamaj u vra vetëm sepse po kërkonte të vërtetën dhe të drejtën.

Nëse në vendin tonë, mes radhëve të administratës, medias, politikës, shoqërisë civile do të kishim më shumë individë me integritet dhe me forcën për të denoncuar padrejtësitë dhe për t'i ndëshkuar, do të kishim një Shtet më të mirë. Por deri më sot, të mirë, ndjehen kaq vetëm.

Vrasjet e 21 Janarit krim shtetëror, dënim edhe për urdhëruesit

Hetimi i ri, ka elementë të krimeve kundër njerëzimit, të parashikuara nga neni 74 i Kodit tonë Penal

MILTIADH M. MUÇI
TIRANE

Edhe pse kaluan katër vjet nga 21 Janari 2011, ku u kryen jo më pak se dhjetë vrasje e tentativë-vrasje, apo plagosje të dhjetra protestuesve të tjerë të pafajshëm, autorët vazhdojnë të ndodhen të lirë. Vetëm dy u dënuan dhe këta me nga 12 muaj burg secili, për viktimat Ziver Veizi e Faik Myrtaj, ndërsa për të tjerët nuk është bërë e mundur të vërtetohet akoma, se kush i ka kryer. Ky është përfundimi i arritur nga Drejtësia jonë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor dhe asaj të Apelit të kryeqytetit, kur pas kërkesës ankimore të organit të prokurorisë, sipas një deklarate në Shkodër në mesin e shkurtit 2015, të Kryetarit të saj Xhezair Zaganjori, pritet gjykimi dhe vendimi përfundimtar i Gjykatës së Lartë. Dy nga autorët, ish-kreu i Gardës, Ndreja Prendi e gardisti Agim Llupo, vërtetë u dënuan me nga 12 muaj burg për vrasje nga pakujdesia, kur dispozita e nën 85 të Kodit Penal përcajton gjobë ose burg gjer në pesë vjet, por ajo është krim kundër jetës dhe jo kundër vajtje, sikurse thuhet në nenin 1, paragrafi i dytë "Mbi ligjin penal dhe ndarjen e veprave penale" të Kodit Penal, ku lexohet se "veprat penale ndahen në krime dhe kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij kodi", sikurse edhe neni 85 i ndodhur në Seksionin II- "Krime kundër jetës shkaktuar nga pakujdesia". Pra, Gjykata e Apelit ndryshe nga e Shkallës së Parë që dha pafajësinë, të dy personat e akuzuar nga prokuroria për nenin 79 të Kodit Penal, "vrasje në rrethana të tjera cilësuese", i deklaroi fajtor për krimin e kryer nga pakujdesia, pra sipas këtij deklarimi komandanti i gardës Ndreja Prendi dhe majori snajper Agim Llupo, kanë kryer krim dhe jo kundërvajtje penale. Kur kanë kaluan katër vjet nga 21 Janari 2011, vrasjet në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", dhe veprimet e turpshme të trupës së policisë, në veçanti të Gardës së Republikës me dy autorët e shpallur tashmë fajtorë, dhe të dënuar për "krimin e vrasjes nga pakujdesia", nuk janë fshirë nga kujtesa jo vetëm e pjesëmarrësve në protestë, por dhe të mijëra të tjerëve, që i ndoqën në ekranet televizive e internet, brenda e jashtë kufijve shtetërorë, duke qenë veçse krime shtetërorë.

HETIMI I RI

Vrasjet e 21 janarit kërkojnë hetim të ri, të thellë dhe "gjihtëpërfshirës", sikurse ka deklaruar në fillimin e tyre dhe ish-ambasadori i SHBA-së në vendin tonë Arvizu. Pse këto vrasje të kryera nga këta autorë e të tjerë, janë jo vetëm krime, por dhe krime shtetërore? Tashmë është vërtetuar shkencërisht, se të paktën dy të vrarë janë qëlluar nga armët që dispononin dy drejtuesit kryesorë, me funksione shtetërore në repartet speciale të Gardës së Republikës. Ata nga ana subjektive kanë vepruar me dashje di-



rekte, nisur nga motivet politike, për bindjet e kundërta të viktimave me të pushtetarëve, duke cënuar jo vetëm marrdhënit juridike të vendosura në harmoni me normat e të drejtës penale ndërkombëtare, në mbrojtje të jetës dhe shëndetit të personit, por dhe të drejtave e lirisë të personit. Ndërsa nga ana objektive, veprimet dhe mosveprimet e autorëve kanë shkaktuar vrasjen e të paktën dhjetë personave, gjashtë të mbetura në tentativë, dhe plagosjen e rrahjen e shumë të tjerëve. Të gjitha këto, përbëjnë elementë të krimeve

VRASJE POLITIKE

Kur kaluan katër vjet nga dita e 21 Janarit 2011, dhe më shumë po vërtetohet se vrasjet, tentativëvrasjet, plagosjet e rrahjet e kryera nga instrumentet e forcave të pushtetit, sikurse janë policia dhe Garda, u kryen vetëm për interesat korruptive të pushtetarëve. Ato ishin të organizuara, të paramenduara, për të ruajtur burimet financiare, të garantuara nëpërmjet trafikimit, sikurse e vërtetoi edhe ndërhyrja në Lazarat, me tonelatat e kanabissativat dhe llojet e kalibrave të mëdha të municioneve e armëve të zjarrit; ndërhyrjet dhe vjedhjet në sistemin bankar, sikur e vërtetoi vrasja e drejtorit të "Credins Bank" me kapital tërësisht shqiptar, dhe brenda muajit vjedhja e thesarit të shtetit; shpërbërja e Sistemit të Arsimit të Lartë piramidale, që implikoi inteligjencien

HETIMI I RI

"Prokuroria të ngrejë akuzat të reja jo vetëm ndaj Ndreja Prendit dhe Agim Lluos, por dhe të tjerëve në shkallët më të larta të herarkisë partiake apo shtetërore".

kundër njerëzimit, të parashikuara nga neni 74 i Kodit tonë Penal.

Ashtu sikurse u dëshën që për tre vjet, dy të akuzuarit nga organi i prokurorisë të deklarohen fajtorë nga Gjykata e Apelit, qoftë për vrasje të kryera nga pakujdesia, besohet shumë se Gjykata e Lartë do të marrë një vendim të ri objektiv dhe të pandikuar nga politika, jo si deri më dje në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe të Apelit, kur çështja duhet të kthehet për atë hetim të plotë e gjithëpërfshirës, që mund t'i hapë rrugë edhe organit të prokurorisë, të ngrejë akuzat të reja jo vetëm ndaj Ndreja Prendit dhe Agim Lluos, por dhe të tjerëve në shkallët më të larta të herarkisë partiake apo shtetërore.

e mbetur brenda vendit të gjithë fushave, për të mos qenë opozita e vërtetë e pushtetit dhe opozitarëve fasadë të çdo rotacioni; masakrimin e Sistemit të Drejtësisë e Shëndetësisë dhe të tjera e të tjera, për ta mbyllur me shkatërrimin e pronësisë dhe pronarëve të vërtetë apo të trashëguar, themelin e ekonomisë së tregut, duke e përvertësuar për 24 vjet me ligje agrare komuniste, të përsëritura njësoj si para 70 vjetëve, të kryera nga të ashtuquajturit pronarë të rinj, kur në të vërtetë mbeten në çdo kohë vetëm vjedhës, hajdutë të pronës. Ashtu sikurse vrasjet e 21 Janarit, të gjitha këto përbëjnë krime të tjera të shtetit nëpërmjet pushtetit, autorët e të cilave tashmë kushdo i di, ndërsa pritet një ditë t'i identifikojnë e dënojnë, për të kthyer gjithçka që kanë vjedhur.



21 janari



Çfarë shkruan Gjeka për 2 prillin, do përsëritet dhe më 21 janar 2011, ku Berisha ishte përgatitur të thoshte se, ato ishin vrasje nga afër me selektor nga persona të opozitës.

Çelaj, i cili i ka ndjekur nga afër veprimet e forcave të rendit, një nga pesë të akuzuarit dhe të dënuarit për këto vrasje, episode që i ka përshkruar me mjaft profesionalizëm, në botimin me titull "Kush vrau më 2 prill", ku midis të tjerash ka shkruar: "Nëse bëhet fjalë për skenar në ngjarjen e 2 prillit, atë mund ta kenë përgatitur vetëm ata që kanë organizuar demonstrimin e paligjshëm dhe vetëm ata që e dinin se, në atë vend dhe në atë kohë, do të ndodheshin aty viktimat e ardhëshme... organizatorë të 2 prillit e kishin përgatitur versionin e fajësisë për pasojat pa nisur ende ngjarja, sepse vetë ngjarja u organizua në shërbim të versionit dhe versioni do t'i shërbente synimit politik të marrjes me çdo kusht të pushtetit në një kohë sa më të shkurtër". Çka shkruan Gjeka për ngjarjen e 2 prillit, do të përsëritet edhe në ngjarjen e 21 janarit 2011, jo se u vranë katër persona, por kryeministri Berisha në deklaratat e para ishte përgatitur të thoshte se, ato ishin vrasje nga afër me selektor nga persona të opozitës, ndërsa kur u vërtetua se, ishin forcat e Gardës që i kishin shkaktuar deklaroi si të ishte eksperti i kriminalistikës se, plumbat më parë kishin bërë rigohetë në degët halore të pishave. 24 vjet në liderin e PD, por dhe të pushtetit, tashmë gjithçka dihet se çfarë ka ndodhur në vendin tonë, me pasojat dhe më të mëdha se ato të ngjarjeve të marsit 1997, kur me armët e ushtrisë dhe sot shtohen viktimat, më të shumta se të viteve të luftës së popullit tonë kundër pushtuesve të huaj.

Rama jep "OK" për nisjen e punimeve të "Loro Boriçit"

Këshilli Kombëtar i Territorit ka Vendosur për të nisur punimet për rikonstruksionin e "Loro Boriçit"

DYLBER BALLA
SHKODER

Shumë shpejt Shqipëria do të ketë dy stadione me standarde Europiane. Pas stadiumit "Elbasan Arena" zyrtarisht do të ketë edhe "Loro Boriçin" në Shkodër, pasi Këshilli Kombëtar i Territorit ka vendosur për të nisur punimet për rikonstruksionin e Stadiumit "Loro Boriçit". Pas kujtesës së para pak ditëve të tifozëve shkodranë për vonesën e punimeve dhe përgjigjes së parë

të Ramës në Facebook, dje ka ardhur edhe përgjigja vendimtare nga kryeministri, që i hap rrugë nisjes së punimeve për rikonstruksionin. "Gjatë mbledhjes së KKT në Shkodër morëm vendim për transformimin e stadiumit "Loro Boriçit" në një stadium të ri me bukurinë arkitektonike që meriton qyteti i pasionit për futbollin. Pamjet e plota të projektit do t'i prezantohen drejtpërdrejtë në ditët në vijim publikisht sportdashës shkodran dhe prezantimi do të bëhet i hapur për të gjithë në fushën e gjelbërt të "Loro Boriçit". Pas Elbasan Arenës kuqezinjët e Kombëtares do të

kenë që këtë vit edhe një arenë tjetër të standardeve të UEFA-s. Ky qytet tashmë do të ketë një stadium ambicioz, ashtu siç e meriton", theksoi kreu i qeverisë. Sipas projektit stadiumi i ri në Shkodër ka një kapacitet prej 17 mijë tifozësh dhe do të kushtojë rreth 15 milionë euro. Rama nuk ka harruar të bëjë batuta edhe për datën 1

"Pas 'Elbasan Arenës' kuqezinjët do të kenë që këtë vit edhe një arenë tjetër. Ky qytet tashmë do të ketë një stadium ambicioz" tha Rama.



Edi Rama prezanton projektin

VIDEO/ KKT MIRATON
PROJEKTIN PËR
STADIUMIN 'LORO BORIÇIN'

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni
QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas



Prill, pasi sipas kryeministrit shkodranët e kanë pasur 1 Prill gjithë vitin për shkak të gënjeshtreve gjatë qeverisë së djathtë. E ndërkohë shefi i qeverisë ka theksuar se dëshpërlimet për pronat e banorëve përreth stadiumit do të bëhen sipas ligjeve në fuqi. Më 2014 pas ndeshjes në Serbi, Rama premtoi se stadiumi i Shkodrës do të jetë gati për ndeshjen e kthimit, e cila do të zhvillohet "Loro Boriçit". Ndeshja e kthimit për eliminatorët e kampionatit Europian është planifikuar që të zhvillohet më datë 8 Tetor 2015. Tashmë mbetet për t'u parë ritmi me të cilin do të ecin punimet për stadiumin e ri dhe nëse do të arrihet që të jetë gjithçka gati për muajin tetor. Nëse stadiumi i Shkodrës nuk do të jetë gati, atëherë ndeshja e kthimit me Serbinë do të zhvillohet në Elbasan, aty ku janë zhvilluar edhe dy ndeshjet e para me Danimarkën dhe Armeninë. Pas startit më të mirë në histori që ka afron me kualifikimin në Europian, Shqipërisë i duhet një stadium akoma më i madh se ai i Elbasanit, pasi kërkesat janë shumë herë më të mëdha. Duke nisur nga dy ndeshjet e fundit që janë zhvilluar në Elbasan shuam tifozë kanë mbetur jashtë duke mos pasur mundësi ta ndjekin ndeshjen nga tribuna, pasi kapaciteti është shumë i vogël, vetëm 12,500 tifozë. Ndërkohë që FSHF vazhdon që të mbajë gjallë shpresat edhe për stadiumin e ri në Tiranë, por duket se kjo ëndërr do edhe shumë vite që të bëhet realitet.

INCIDENTI/ SUPERIORE

Incidenti me flamurin, Apolonia largon portierin serb

Ekipi fierak ka vendosur të largojë dy serbët pas skandalit të shpërthyer në ndeshjen Apolonia- Tirana, Cakovic e Xhorxhevic

Disa ditë pas skandalit në Fier në ndeshjen Apolonia-Tirana, ku portieri Cakovic largoi flamurin shqiptar në shenjë nervozizmi, Apolonia vendos largimin, jo vetëm të portierit, por edhe një tjetër lojtar serb. Sipas njoftimit të klubit në faqen zyrtare të Facebook, Apolonia ka vendosur të largojë dy serbët

pas skandalit të shpërthyer në ndeshjen e kampionatit Apolonia- Tirana. "Portieri serb Vilson Cakovic, i cili u përishi në një veprim të pamenduar mirë dhe me më pas në disa intervista me doza nacionaliste nuk do ta vazhdojë më karrierën të skuadra shqiptare e Apolonisë. Të njëjtin fat me portierin gjaknxehtë, do të



ketë edhe bashkëpatrioti i tij, mesfushori Xhorxhe Xhorxhevic. Të dy lojtarët serbe nuk do të vazh-

dojnë të jenë pjesë e klubit thuhet në një deklaratë për shtyp të klubit fierak. Në deklaratë bëhet e ditur se

është rënë dakord nga të dy palët që kontrata të zgjidhet me marrëveshje" thuhet në njoftimin e klubit.

KOMISIONI I DISIPLINËS DËNON APOLONINË

Ndërsa po dje ka folur edhe Disiplina duke dënuar Apoloninë me një ndeshje pezullim. Dënimi nga Komisioni i Disiplinës ka të bëjë me episodin kur u fut në fushë tifozë fierak dhe portieri serb i Apolonisë Vilson Cakovic ndërhyri duke i rrëmbyer flamurin shqiptar. "Apolonia për dështim në përmbyshjen e përgjegjësiëve për sigurinë e zyrtareve të ndeshjes dhe hyrjen në fushën e lojës të personave të pa autorizuar pa shkaktuar akte dhune, dënohet me zhvillimin e ndeshje pa spektator në stadiumin përkatës si dhe detyrimin e dëshpërlimit të shkaktuar ndaj zyrtarit të ndeshjes". Përsa i përket zyrtarit të ndeshjes, fjala është për arbitrin, të cilin iu thyen xhamat e makinës. Edhe Kukësi për hyrjen në fushën e lojës të personave të pa autorizuar pa shkaktuar akte dhune, dënohet me zhvillimin e 1 ndeshje pa spektator në stadiumin përkatës. Lojtari i Kastriotit, Pellumb Zela për goditje ndaj lojtarit kundërshtar, dënohet me 5 ndeshje pezullim. Lojtari e Terbunit, Matko Djarmarti dhe Bledar Murati për goditje ndaj lojtarit kundërshtar dënohen secili me 5 ndeshje.



Deklarata



Cakovic

Në një tjetër intervistë nga Serbia, Cakovic tha se "pas ndeshjes kam folur me mediat në Shqipëri dhe ua kam bërë të qartë se nëse situata do të përsëritej do ta bëja sërish të njëjtin gjë".



Dhuna

Kukësi për hyrjen në fushën e lojës të personave të pa autorizuar pa shkaktuar akte dhune, dënohet me zhvillimin e 1 ndeshje pa spektator në stadiumin përkatës.

Shkurt

DEDIKIMI

Mavraj: Falënderoj babin tim, mezi prita ta lumturoj

— Heroi i Shqipërisë, Mavraj ka një status të veçantë për babanë e tij. "Falënderoj babin tim, një njeri i mrekullueshëm që mezi prita ta lumturoj. Një falënderim i veçantë dhe përzemërt shkon për ata tifozë të mrekullueshëm që më përkrahen" shkruan mbrojtësi në Facebook.



SULMUESI

Tare në sulm për të marrë te Lazio Shkëlzen Gashin

— Igli Tare është i interesuar që edhe Gashi të transferohet te Lazio duke iu bashkuar kolonisë kuqezi në Serie A. 20 gola të shënuara në këtë edicion nga sulmuesi Shkëlzen Gashi. Bazeli kërkon 8 milionë euro për sulmuesin, i cili e shënoi golin e fitores për Shqipërinë.

LAJME
nga bota

Mori incidentesh në Turqi

— Incidentet në Stamboll kanë vazhduar edhe dje. Dy persona janë neutralizuar pranë zyrave qendrore të policisë, me të gjitha gjasat në përpjekje për t'i sulmuar ato. Njëra prej agresorëve, femër, ka gjetur vdekjen, ndërkohë që sulmuesi tjetër ka mbetur i plagosur. Ndërsa disa orë më parë, një person u fut dhunshëm në zyrat qendrore të partisë në pushtet, AK. Një ditë më parë, Mehmet Selim Kiraz dhe dy agresorët që e morrën peng mbetën të vvarë në shkëmbim zjarri me forcat speciale. Prokurori kishte hetuar rastin e një adoleshenti që u qëllua në protestat anti-qeveritare të vitit 2013 e që vdiq pas 9 muajsh në gjendje kome. 19 anëtarë të grupit majtist DHKP-C u arrestuan në Antalia.

ISIS i afrohet Damaskut

— ISIS vazhdon të zgjerojë gjeografinë e territoreve nën kontrollin e tij në Siri. Aktivistë dhe zyrtarë palestinezë lëshuan alarmin se militantët ekstremistë kanë hyrë dje në kampin palestinez të Yarmouk-ut në Damask, duke marrë nën kontroll pjesën më të madhe të tij. Raportohet për luftime mes militantëve dhe grupeve palestineze brenda kampit. Kampi është ngritur në vitin 1948, gjatë luftës së vendeve arabe me Izraelin për të pritur dhe strehuar përkohësisht refugjatët palestinezë. Para nisjes së luftës civile në Siri në kamp numëroheshin 150 mijë refugjatë palestinezë.

Irani s'jep OK për atomiken

— Irani nuk po pranon marrëveshjen e propozuar nga gjashtë fuqi të mëdha lidhur me energjinë bërthamore. Në Lozanë të Zvicrës pesë anëtarët e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Gjermania po përpiqen ende ta mbajnë larg atë një vit nga mundësia për të ndërtuar bombën atomike. Kjo për të fituar kohë, që nëse Irani e shkel marrëveshjen, të vendosen sanksione ekonomike ose aksione ushtarake. Por Irani është negociator i vështirë. Këtë e tregoi edhe me kthesën e papritur me dërgesat e uranimit të pasuruar në Rusi, tashmë të pranuar. Ndërkohë, duket se presidenti amerikan Obama e do marrëveshjen pothuajse me çdo kusht.

KINOSTUDIO
nga Admirina Peçi

Sekretet e filmave të para '90-s përmes rrëfimeve të protagonistëve...

Çdo të diei në **A1 REPORT!**

ora 16:10
ritransmetimi në 22:30

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Aurel Pepa - Zv/kryeredaktor
Genc Kondi - Administrator i Përgjithshëm; Admirina Peçi - Kryeredaktore e "Rilindasi"; Politika: Juxhin Mustafaraj; Ekonomi: Lorenc Rabeta; Aktualitet: Elton Qyno ;
Social: Sonila Isaku; Kulturë: Dhurata Hamzai; Sport: Dylber Balla; Design: Altin Allaj, Erjon Ymeri; Website: Greta Malaj; Shpërndarja: Spiro Meshini cel: +355696088847

Departamenti i Marketingut:
Vera Përleka
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë